



TRAGJEDIA NË VJENË: TRE BASHKATDHEHTARË HUMBIN JETËN NË VENDIN E PUNËS, KOSOVA BASHKËNDIEN DHIMBJEN ME FAMILJET I FAQE 4-5



Tre shtetas të Kosovës kanë humbur jetën si pasojë e një aksidenti në një punishte ndërtime në Vjenë. Sipas njoftimit të Ambasadës së Kosovës në Austri, aksidenti ka ndodhur në

distriktin Alsergrund, gjatë punimeve ndërtimore, kur një pjesë e konstruksionit është shembur, duke lënë punëtorë të bllokuar nën rrënoja. Autoritetet austriake nuk kanë

dhënë ende hollësi të plota për shkaqet e shembjes së konstruksionit, ndërsa hetimet për rastin pritet t'i sqarojnë përgjegjësitë dhe kushtet e sigurisë në punishte

AKTUALE



VLERËSOHET BASHKËPUNIMI I SHKËLOYER NDËRMJET FSK-së DHE AJOVËS F. 3

TAHIRI: QEVERIA KURTI ME KABINETIN MË TË MADH NË RAJON DHE PA PROGRAM F. 5

ARSIM BAJRAMI PROMOVON LIBRIN 'KONFERENCA E RAMBUJESË DHE INTERVENIMI I NATO-S NË KOSOVË' F. 6

EKONOMI



BQK-JA THEKSON RËNDËSINË E EDUKIMIT FINANCIAR NË NDARJEN E ÇMIMEVE TË GARËS PËR BANKIERË TË RINJ F. 8

ZYRTARË TË ARBK-SË MERREN NË PYETJE NËN DYSHIMIN PËR KEQPËRDORIM TË DETYRËS F. 8

SPORT



NIS ZGJERIMI I QENDRËS NACIONALE TË XHUDOS NË PEJË, PROJEKT NË VLERË MBI 5.7 MILIONË EURO F. 11



SHTESA E PËRVOJËS: SI U SHKELËN TË DREJTAT E RRETH 90 MIJË PUNONJËSVE TË SEKTORIT PUBLIK F. 3



KURTI NUK ËSHTË MË SHPRESA E KOSOVËS, MODELI I TIJ ËSHTË KONFLIKTI I PËRHERSHËM DHE SHUMË MË PAK SHTET SESA ËSHTË PREMTUAR F. 6

Shkruan: Ramush HARADINAJ

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mod: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

IRANI NIS SULME HAKMARRËSE NË GJITHË LINDJEN E MESME PAS GODITJES SË CENTRALIT BËRTHAMOR

TEHRAN, 18 MARS - Një breshëri raketash iraniane i ka vrarë dy njerëz në Izrael, pasi Teherani u zotua për hakmarrje pas vrasjes së shefit të sigurisë, Ali Larijani, dhe raportimeve se i vetmi central energjetik bërthamor i Iranit është goditur nga një predhë e pidentifikuar. Autoritetet iraniane konfirmuan më 17 mars se Larijani, shefi i fuqishëm i sigurisë së vendit, është vrarë. Ai ishte zyrtari me profilin më të lartë që u vra që nga vrasja e udhëheqësit suprem, Ajatollah Ali Khamenei, në ditën e parë të sulmeve ajrore të ShBA-së dhe Izraelit më 28 shkurt. Teherani më pas lëshoi disa raketa drejt Izraelit gjatë natës, duke vrarë dy njerëz pranë Tel Avivit, duke thënë se sulmet u kryen për ta “nderuar” vdekjen e Larijanit. Sulmi në një lagje pranë zonave me popullsi të dendur të Tel Avivit, ku ndodhen gjithashtu instalime të rëndësishme ushtarake, e çoi numrin e të vdekurve në luftën në Izrael në të paktën 14. Në një deklaratë të lexuar nga Trupat e Gardës Revolucionare Islamike në televizionin shtetëror thuhej se në këto sulme u përdorën raketa Khoramshahr-4 dhe Qadr, të cilat bartin disa koka luftarake. Izraeli e ka akuzuar Iranin për përdorim të përsëritur të municioneve thërrmuese, të cilat ndahen në disa bomba më të vogla gjatë fluturimit dhe përhapen në një zonë të gjerë, duke i bërë të vështira për t'u ndaluar. Mediet iraniane më 18 mars raportuan për sulme në provincën Lorestan dhe në qytetin Hamedan, të dyja në perëndim të Iranit, si dhe në provincën jugore Fars. Izraeli, gjithashtu, i rriti sulmet ndaj caqeve që, sipas tij, janë të lidhura me Hezbollahun e mbështetur nga Irani - të cilin Shtetet e Bashkuara e kanë cilësuar si organizatë terroriste - në Liban. U raportua për disa të vdekur në këto sulme, të cilat po rrisin shqetësimet për zgjerimin e konfliktit në të gjithë Lindjen e Mesme. Ndërkohë, Rosatom, operatori rus i centralit bërthamor Bushehr në Iranin perëndimor, tha se një predhë goditi një zonë pranë objektit më 17 mars, megjithëse nuk u raportuan dëme, të lënduar apo rrjedhje rrezatimi. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike bëri thirrje për “përmbytje maksimale”. “Drejtori i Përgjithshëm i IAEA-



së, Rafael Grossi, përsërit thirrjen për përmbytje maksimale gjatë konfliktit për ta parandaluar rrezikun e një aksidenti bërthamor”, tha mbikëqyrësi bërthamor në një postim në X. Bushehri është i vetmi central bërthamor i Iranit. I vendosur në bregdetin verior të Gjirit Persik, ai furnizohet me uranium të prodhuar në Rusi, jo në Iran, dhe monitorohet nga IAEA. Disa shpërthime u dëgjuan gjithashtu në Jerusalem më 18 mars, pasi ushtria izraelite njoftoi se kishte zbuluar një valë të re raketash të lëshuara nga Irani. Larijani u vra së bashku me djalin e tij Morteza, zëvendësin e tij Alireza Bayat dhe disa truproja, tha sekretariati i Këshillit të Lartë të Sigurisë Kombëtare të Iranit në një deklaratë më 17 mars. Larijani ishte sekretar i Këshillit të Lartë të Sigurisë Kombëtare. Në anën tjetër, Trupat e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) konfirmuan vdekjen e Gholamreza Soleimani, komandant i forcës paraushtarake Basij të Iranit, duke dhënë pak hollësi. Forcat e Mbrojtjes së Izraelit (IDF) kishin thënë se Soleimani dhe Larijani ishin vrarë në të njëjtën seri sulmesh më 16 mars. Më 18 mars, ministri izraelit i

Mbrojtjes, Israel Katz, tha se ushtria e vendit vrau gjithashtu ministrin iranian të Inteligjencës, Esmail Khatib. Derisa nuk ka pasur konfirmim nga Irani për vdekjen e Khatibit, IDF-ja tha se ai u “eliminua” në një sulm në Teheran. Ofensiva ShBA-Izrael ndaj Iranit, tashmë në javën e tretë, nuk po tregon shenja zbutjeje, dhe sirenat e sulmeve ajrore u dëgjuan në disa vende në të gjithë Lindjen e Mesme më 18 mars. Disa shpërthime të forta u dëgjuan në Dubai më 18 mars, ndërsa zyrtarët e Emirateve njoftuan se sistemet e mbrojtjes ajrore po luftonin kërcënimin nga raketat dhe dronët e lëshuar nga Irani. Emiratat e Bashkuara Arabe thanë se sistemet e tyre të mbrojtjes ajrore kishin interceptuar 13 raketa balistike dhe 27 dronë të lëshuar nga Irani më 18 mars. Sipas zyrtarëve, më shumë se 2 000 dronë dhe raketa janë lëshuar drejt vendit nga Irani që nga fillimi i luftës. Ushtria amerikane njoftoi se kishte sulmuar pozicionet raketore iraniane pranë Ngushticës strategjike të Hormuzit duke përdorur të

bomba depërtuese të bunkerëve. Komanda Qendrore e ShBA-së tha në një deklaratë në platformën X më 17 mars se forcat amerikane kishin përdorur me sukses “disa bomba depërtuese” kundër vendeve të fortifikuara raketore iraniane në bregdet pranë Ngushticës së Hormuzit. Ajo shtoi se “raketat lundruese kundër anijeve të vendosura në këto lokacione përbënin kërcënim për transportin ndërkombëtar në këtë rrugë strategjike”. Pavarësisht prej sulmeve të vazhdueshme që po tronditin rajonin, presidenti amerikan Donald Trump, duke folur nga Shtëpia e Bardhë më 17 mars, këmbënguli se lufta nuk do të zgjasë shumë. Duke folur për operacionin ushtarak të administratës së tij kundër Iranit, ai tha: “Na duhej të bënim një mision të shkurtër për t’u përballur me armët bërthamore që ishin në duart e disa njerëzve të çmendur por, përveç kësaj, [lufta] do të përfundojë brenda një ose dy javësh dhe nuk do të zgjasë shumë”. Trumpi nuk dha afat kohor, duke shtuar se “gjithçka po lëviz

shumë shpejt” dhe se “jemi shumë përpara afatit”. Ai tha se Shtetet e Bashkuara ishin njoftuar nga shumica e aleatëve të saj në NATO se nuk dëshirojnë të përfshihen në operacionin e saj ushtarak në Iran. Trumpi kishte bërë thirrje për ndihmë për sigurimin e transportit përmes Ngushticës së Hormuzit, të cilën Teherani e ka mbyllur duke i sulmuar anijet dhe duke bërë kërcënime ndaj të tjerave. Disa vende kishin thënë se do ta shqyrtonin një lëvizje të tillë, por shumë të tjera nuk pranuan të përfshihen. Një zyrtar i lartë i Emirateve të Bashkuara Arabe tha se vendi po shqyrton mundësinë e bashkimit me nismën detare amerikane. Anwar Gargash, këshilltar diplomatik i presidentit të Emirateve të Bashkuara Arabe, tha se negociatat po vazhdojnë në këtë drejtim, por një vendim përfundimtar ende nuk është marrë, dhe theksoi se siguri i tregtisë dhe energjisë është përgjegjësi e përbashkët e vendeve të mëdha. Shënjestrimi nga Irani i vendeve prodhuese të naftës dhe gazit në Gjirin Persik ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e çmimeve të energjisë në shumë vende.

TRAGJEDIA NË VJENË: TRE BASHKATDHETARË HUMBIN JETËN NË VENDIN E PUNËS, KOSOVA BASHKËNDIEN DHIMBJEN ME FAMILJET

Tre shtetas të Kosovës kanë humbur jetën si pasojë e një aksidenti në një punishte ndërtimi në Vjenë. Sipas njoftimit të Ambasadës së Kosovës në Austri, aksidenti ka ndodhur në distriktin Alsergrund, gjatë punimeve ndërtimore, kur një pjesë e konstruksionit është shembur, duke lënë punëtorë të bllokuar nën rrënoja. Autoritetet austriake nuk kanë dhënë ende hollësi të plota për shkaqet e shembjes së konstruksionit, ndërsa hetimet për rastin pritet t’i sqarojnë përgjegjësitë dhe kushtet e sigurisë në punishte

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 MARS - Të martën rreth orës 14:15 në Vjenë të Republikës së Austrisë ka ndodhur një aksident i rëndë në një kантиer ndërtimi si pasojë e të cilit kanë humbur jetën disa persona, në mesin e tyre tre bashkatdhetarë nga Kosova. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka njoftuar se, sipas informacioneve zyrtare të konfirmuara nga autoritetet austriake, aksidenti ka ndodhur në distriktin Alsergrund të Vjenës gjatë punimeve ndërtimore, ku si pasojë e shembjes së një pjese të konstruksionit, disa punëtorë kanë mbetur të zënë nën rrënoja. Bazuar në konfirmimet zyrtare dhe në informacionet e siguruara përmes kontakteve me familjarët, deri në këto çaste është konfirmuar se nga viktimat e identifikuara janë Pajtim Bajrami, Asllan Musliu dhe Istref Zekaj me prejardhje nga Republika e Kosovës. Autoritetet austriake nuk kanë dhënë ende hollësi të plota për shkaqet e shembjes së konstruksionit, ndërsa hetimet për rastin pritet t’i sqarojnë përgjegjësitë dhe kushtet e

sigurisë në punishte. Që nga marrja e informacionit, institucionet e Republikës së Kosovës, përmes kanaleve diplomatike dhe konsullore, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në koordinim të ngushtë me familjarët e viktimave, për ta ofruar mbështetjen e nevojshme dhe për t’i lehtësuar procedurat përkatëse për kthimin e trupave të tyre në Kosovë. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka shprehur ngushëllimet më të sinqerta për familjet dhe të afërmit e viktimave si dhe të gjithë të prekurit nga kjo tragjedi. Ngushëllime familjarëve u kanë shprehur edhe liderët shtetërorë të Kosovës dhe liderët e opozitës. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka reaguar duke ngushëlluar familjet e tre bashkatdhetarëve dhe duke theksuar se kjo tragjedi ka lënë një dhimbje të thellë e të pashuar jo vetëm te familjet e tyre, por te të gjithë bashkatdhetarët. “I përhershëm qoftë kujtimi për Pajtim Bajramin, Asllan Musliun dhe Istref Zekajn!”, ka thënë Osmani. Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, shprehu tronditjen për ngjarjen dhe theksoi se



institucionet janë në koordinim për t’u dalë në ndihmë familjeve të viktimave. “Në këto çaste të rënda, shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta për familjet e viktimave dhe të gjithë ata që janë prekur nga kjo humbje e madhe”, ka shkruar Kurti. Edhe kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, tha se është tronditur nga vdekja e tre qytetarëve të Kosovës në vendin e punës në Vjenë, duke e cilësuar humbjen si dhimbje që prek të gjithë. “Në këto çaste të vështira shpreh ngushëllimet më të sinqerta për familjet dhe të afërmit e tyre. Ndajmë dhimbjen me ta dhe qëndrojmë pranë tyre në këtë humbje të madhe”, ka shkruar Haxhiu. Edhe ministri i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca, ka shprehur ngushëllime për humbjen tragjike të jetës së tre qytetarëve të Republikës së Kosovës në Vjenë të Austrisë si pasojë e një aksidenti në vendin e punës gjatë pasdites së djeshme.

“Që nga marrja e lajmit e deri tani, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes Ambasadës së Republikës së Kosovës në Vjenë, ka qenë dhe vazhdon të jetë në koordinim të vazhdueshëm me familjet dhe autoritetet përkatëse për të siguruar mbështetjen e plotë dhe për të lehtësuar çdo procedurë të nevojshme”, ka shkruar ai në “Facebook”. Ai ka shtuar se: “Asllan Musliu, Istref Zekaj dhe Pajtim Bajrami ishin pjesë e diasporës sonë - një shtyllë e pazëvendësueshme e Kosovës. Për dekada, njerëzit tanë jashtë vendit kanë mbajtur gjallë lidhjen me atdheun, kanë mbështetur familjet e tyre, kanë kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, dhe kanë qenë zë i Kosovës kudo në botë. Humbja e tyre nuk është vetëm humbje për familjet, por edhe për gjithë shoqërinë tonë që në kohët më të vështira ka gjetur mbështetjen kryesore në përkushtimin dhe

sakrificën e bashkatdhetarëve tanë. Në këtë ditë të rëndë për Kosovën, shpreh ngushëllimet e mia më të thella për familjet dhe të afërmit e viktimave dhe të gjithë ata që janë prekur nga kjo humbje e madhe”, ka shkruar Konjufca. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, në “Facebook” ka shkruar se në këto çaste të vështira me mendje dhe zemër janë pranë familjarëve të viktimave. Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se në këto çaste dhimbjeje, shpreh ngushëllimet më të sinqerta për familjet e viktimave, të afërmit dhe të gjithë qytetarët që janë prekur nga kjo humbje e rëndë. Ngushëllime familjeve u ka shprehur edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, duke theksuar se në këto ndan dhimbjen me familjet e viktimave dhe me të gjithë ata që i njohën.



Vlerësohet bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet FSK-së dhe Ajovës

Prishtinë, 18 mars - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (KOMFSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari, priti sot në takim rreshter-majorin komandues të Gardës Nacionale të Ajovës (IANG), Matthew T. Strasser. Gjatë takimit të tyre u diskutua për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet FSK-së dhe Gardës Nacionale të Ajovës, me fokus të veçantë në zhvillimin dhe avancimin e trupës së

nënoficerëve. Gjeneral Jashari vlerësoi kontributin e partnerëve amerikanë, posaçërisht të Gardës Nacionale të Ajovës, për ndërtimin e një strukture të fortë dhe profesionale të nënoficerëve brenda FSK-së. Nga ana tjetër, rreshter-majori i Komandës Strasser vlerësoi lart leadershipin e gjeneral Jasharit në mbështetje të zhvillimit të karrierës ushtarake për të gjithë personelin e FSK-së, në veçanti

për mbështetjen e dhënë korit të nënoficerëve të FSK-së, duke theksuar rëndësinë dhe përkushtimin për zhvillimin e nënoficerëve si shtylla kryesore e FSK-së. Në fund të takimit, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, e dekoroi rreshter-majorin e Komandës Strasser me medaljen “Shërbim Vetëmohues” për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Forcës së Sigurisë së Kosovës.





SHTESA E PËRVOJËS: SI U SHKELËN TË DREJTAT E RRETH 90 MIJË PUNONJËSVE TË SEKTORIT PUBLIK

Vitet e fundit mësimdhënësit, policët, mjekët dhe çdo punonjësit tjetër i sektorit publik kanë marrë paga më të ulëta se ato që u takonin për shkak të një ndryshimi ligjor antikushtetues që reduktoi shpërblimin për përvojën e punës. Ndryshimi i kërkuar nga Gjykata Kushtetuese duket se më në fund do të zbatohet, por vetëm përmes Ligjit për Buxhetin e vitit 2026, e jo përmes Ligjit për Pagat. Kjo gjë ka ngjallur pakënaqësi. Punonjësit kërkojnë kompensim retroaktiv për humbjet e viteve të fundit, pa pasur nevojë të drejtohen në gjykata

PRISHTINË, 18 MARS - Mësimdhënësi i matematikës, Qamil Hajdini, me mbi tri dekada përvojë në arsim, thotë se puna e tij është formësuar pikërisht nga përvoja që ka fituar ndër vite në klasë. Hajdini, i cili punon në Shkollën Fillore “Zenel Hajdini” në Prishtinë, tregon se kur qeveria vendosi ta përgjysmonte shtesën për përvojën e punës për 15 vjetët e parë, reagimi i mësimdhënësve ishte i menjëhershëm. “Viti i përvojës është vit përvojë si në vitin e parë, si pas 15 vjetëve”, thotë ai. Për të, dëmi nuk është vetëm financiar. “Edhe nëse janë 15 euro, me to mund ta bësh, për shembull, një pagesë komunale... por, më e rëndësishmja është që

ndihesh keq kur e sheh që e drejta jote nuk po respektohet”, shton Hajdini për Radion Evropa e Lirë.

Për çfarë bëhet fjalë?

Shtesa për përvojën e punës është një përqindje që i shtohet pagës bazë për çdo vit të kaluar në punë në sektorin publik. Që nga viti 2010 kjo shtesë ishte e përcaktuar në 0.5 për qind të pagës për çdo vit pune. Kjo do të thotë se, për shembull, një punonjës me dhjetë vjet përvojë përfitonte 5 për qind mbi pagën bazë, ndërsa një me 20 vjet përvojë, 10 për qind. Kjo politikë synonte që përvoja të shpërblehej financiarisht dhe punonjësit të motivoheshin të qëndronin në sektorin publik.

Megjithatë, me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik të vitit 2022, kjo shtesë u ndryshua: për 15 vjetët e parë të punës ajo u përgjysmua në 0.25 për qind për çdo vit, ndërsa vetëm pas vitit të 15-të mbeti në 0.5 për qind. Gjykata Kushtetuese e shpalli këtë reduktim antikushtetues, duke vlerësuar se cenon të drejtat e fituara të punonjësve publikë. Hajdini thotë se, pas aktgjykimit të Kushtetueses, ai dhe kolegët e tij u janë drejtuar gjykatave, por se po përballen me vonesa për shkak të numrit të madh të lëndëve. Radio Evropa e Lirë kontaktoi Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ta pyetur për numrin e lëndëve që janë parashtruar lidhur me këtë çështje, por nuk mori përgjigje

deri në publikimin e artikullit. Në maj të vitit 2025, gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Argzon Muçaj, kishte thënë për Betimin për Drejtësi - medium i specializuar për çështje të drejtësisë - se vetëm brenda një dite atyre u ishin dorëzuar rreth 2 000 padi. Sipas Naim Jakajt, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi, kjo është pasojë direkte e moszbatimit të vendimit të Kushtetueses. “Vazhdimi i kësaj situatë rrezikon ta mbingarkojë gjyqësorin me padi individuale, duke prodhuar pasoja serioze financiare dhe institucionale për shtetin”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Ngarkesë të ngjashme gjykatat në Kosovë kanë përjetuar edhe nga paditë e shumta që lidhen me kontratat kolektive të cilat janë marrëveshje ndërmjet punëdhënësve dhe sindikatave që përcaktojnë të drejtat dhe përfitimet e punëtorëve, si shtesat në paga apo kompensimet shtesë. Edhe në ato raste numri i madh i kërkesave individuale kishte krijuar vonesa dhe kishte rënduar

sistemin gjyqësor.

Cila është zgjidhja?

Edhe mbi dy vjet më vonë, ndryshimi i kërkuar nga Gjykata Kushtetuese nuk është zbatuar ende. Radio Evropa e Lirë pyeti Qeverinë e Kosovës lidhur me këtë çështje, por nuk mori përgjigje. Përmes buxhetit të ri vjetor, qeveria ka lënë të kuptohet se shtesa prej 0.5-përqindësh për përvojën e punës pritet të reflektohet në paga duke filluar nga ky muaj. Megjithatë, sipas Jakajt, problemi nuk është vetëm zbatimi në praktikë, por edhe mungesa e ndryshimeve ligjore që kërkojnë nga aktgjykimi i Kushtetueses. “Tentativa për ta rregulluar këtë çështje përmes një ligji njëvjeçar buxhetor, e jo përmes ndryshimit të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, siç është kërkuar shprehimisht nga Gjykata Kushtetuese, nuk e përmbush standardin e kërkuar kushtetues”, thotë Jakaj. “Një

KURTI NUK ËSHTË MË SHPRESA E KOSOVËS, MODELI I TIJ ËSHTË KONFLIKTI I PËRHERSHËM DHE SHUMË MË PAK SHTET SESA ËSHTË PREMTUAR



Shkruan: Ramush HARADINAJ

Albin Kurti nuk është më premtim. Ai është bilanc. Që nga viti 2019 Albin Kurti ka kërkuar besimin e qytetarëve në emër të ndryshimit. Për një kohë, shumë njerëz e panë si alternativë ndaj politikës së mëparshme dhe si mundësi për një shtet më të fortë, më të drejtë dhe më funksional. Por ajo kohë ka kaluar. Sot ai nuk është më

premtim. Sot ai është bilanc. Dhe bilanci i tij nuk matet me fjalët që thotë për veten, por me gjendjen e vendit. Pyetja është e thjeshtë: a është bërë Kosova më stabile, më funksionale dhe më e fortë si shtet pas gjithë këtyre viteve me Albin Kurtin në krye të pushtetit? Përgjigjja është jo. Në këto vite kemi parë krizë pas krize, bllokadë pas bllokade dhe

përplasje të vazhdueshme politike e institucionale. Tensioni është kthyer në mënyrë qeverisjeje. Edhe zhvillimet e fundit me presidenten Osmani dhe me Gjykatën Kushtetuese e bënë të qartë se problemi nuk është vetëm tek opozita, as vetëm tek rrethanat. Problemi është vetë modeli i pushtetit të Albin Kurtit, i cili prodhon tension edhe brenda institucioneve më të larta të shtetit. Kjo është çështja thelbësore. Një kryeministër mund të ketë dallime politike me kundërshtarët, mund të ketë mosmarrëveshje me partnerët dhe mund të përballet me sfida të vështira. Por kur krizat përsëriten vazhdimisht, atëherë nuk kemi më të bëjmë me raste të veçuara. Kemi të bëjmë me një model. Dhe modeli i Albin Kurtit është pikërisht ky: konflikt i përhershëm, mobilizim i përhershëm dhe shumë më pak shtet sesa është premtuar. Por qytetari i Kosovës nuk jeton nga konfliktet e qeverisë. Ai jeton nga paga, nga puna, nga çmimet, nga faturat, nga qiraja dhe nga siguria për familjen e vet. Pikërisht këtu ndihet më fort dobësia e kësaj qeverisjeje. Jeta

është bërë më e rëndë, çmimet janë rritur dhe familjet e ndiejnë këtë çdo ditë. Po, qeveria ka shpërndarë ndihma dhe ka rritur shtesa. Askush nuk është kundër ndihmës për qytetarin. Por ndihma nuk është zhvillim. Pagesa nuk është reformë. Transferi nuk është ekonomi. Edhe diaspora shqiptare, e cila për vite me radhë i ka dhënë Albin Kurtit një mbështetje të fortë politike dhe emocionale, duhet ta shohë bilancin e kësaj qeverisjeje. Dashuria për Kosovën nuk matet vetëm me duartrokitje për një retorikë të fortë, por edhe me pyetjen nëse vendi po bëhet më i jetueshëm, më funksional dhe më i sigurt për investim, kthim dhe të ardhme. Diaspora nuk ka nevojë vetëm për simbolikë, por për një shtet që punon, për rend, për ligj, për institucione që japin besim dhe për një ekonomi që krijon mundësi reale. Një shtet serioz nuk matet vetëm me atë që shpërndan, por me atë që ndërton. Matet me ekonominë që forcon, me projektet që çon përpara, me stabilitetin që krijon dhe me besimin që ua jep qytetarëve se e nesërmbja mund të jetë më e mirë. Pikërisht këtu qëndron dështimi i

madh i Albin Kurtit. Ai ka ditur të prodhojë marketing, konflikt dhe përçarje politike, por nuk ka ditur të ndërtojë në të njëjtën masë shtet funksional, zhvillim ekonomik dhe qetësi institucionale. Madje problemi është edhe më i thellë. Edhe nëse ai fiton përsëri, kjo nuk do të thotë automatikisht stabilitet për vendin. Përvoja na ka treguar se edhe kur ai fiton, kriza nuk zhduket. Ajo vazhdon në forma të reja, sepse modeli i tij nuk prodhon qetësi dhe bashkëpunim institucional, por përplasje të reja. Kosova nuk ka nevojë për një kryeministër që flet përditë si në fushatë. Ka nevojë për shtet që punon, për institucione që respektojnë njëra-tjetrën, për ekonomi që lëviz dhe për politikë që ndërton. Qytetari ka të drejtë sot të kërkojë jo edhe një premtim tjetër, por një llogari të thjeshtë: çfarë ka prodhuar gjithë ky pushtet? Për këtë arsye duhet thënë qartë: Albin Kurti nuk është më shpresa e Kosovës. Ai është bilanci i një epoqe që premtoi shumë, prodhoi shumë konflikt dhe ndërtoi më pak se sa kishte detyrimin të ndërtonte. Koha e premtimeve ka kaluar. Tani është koha e bilancit.

Tahiri: Qeveria Kurti me kabinetin më të madh në rajon dhe pa program

Prishtinë, 18 mars - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka paraqitur të mërkurën një strukturë të analizës së kabinetit të qeverisë Kurti, e cila përbehet nga 21 anëtarë dhe 453 persona staf politik. “Qeveri e stërmbushur me të emëruar politikë, ministri fiktive dhe pa program”, ka thënë Tahiri. Ai ka thënë se ky kabinet qeveritar ka një strukturë që në vend të efikasitetit, reflekton një zgjerim të tepruar të emërimeve

politike. “Rregullorja e re synonte rregull dhe qartësi, por në praktikë kemi mbi 200 këshilltarë politikë dhe dhjetëra këshilltarë të jashtëm, ndërsa administrata profesionale mbetet në rol dytësor. Kryeministri me buxhet të shtetit/pare të popullit, deri në 24 këshilltarë, zëvendës-kryeministrat deri në 11 secili, ministrat deri në 7, dhe së paku 2 zëvendësministra për çdo ministri pa ndarje të qartë përgjegjësish - një model që

prodhon më shumë poste sesa rezultate”, ka thënë Tahiri. Ai ka thënë se në krahasim me rajonin dhe vendet e Bashkimit Evropian, kjo strukturë është dukshëm më e madhe dhe më e kushtueshme, me rreth 26 staf për ministër, shumë mbi mesataren evropiane. “Në vend të një qeverie funksionale dhe të orientuar drejt rezultateve, po shohim një sistem të ndërtuar për rehati politike, pa vizion të qartë dhe pa program konkret”, ka thënë Tahiri.



qasje e tillë krijon pasiguri juridike dhe nuk garanton zbatim të qëndrueshëm të aktgjykimit kushtetues”, shton ai. Neni 31 i këtij ligji parasheh që shtesa prej 0.5-përqindësh të zbatohet nga ky vit, duke lënë një boshllëk dyvjeçar nga hyrja në fuqi e aktgjykimit. Gjatë këtyre dy vjetëve që nga aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, mbi 90 mijë punonjës në sektorin publik - përfshirë mësimdhënësit, policë, zjarrfikës dhe punëtorë të administratës - kanë pësuar dëm financiar.

Sa para janë humbur?

Për shembull, nëse një mësimdhënësi ka pagë bazë 600

euro dhe 15 vjet përvojë pune: Me normën ligjore 0.5 % ai do të përfitonte rreth 7.5 % shtesë (45 euro në muaj). Me normën e reduktuar 0.25 % ai ka marrë rreth 3.75 % (22.5 euro në muaj). Pra, dallimi për të është rreth 22.5 euro në muaj. Nëse kjo llogaritet nga janari i vitit 2023, kur u bë ndryshimi në Ligjin për Pagat, deri në fund të vitit 2025 (rreth 36 muaj), humbja arrin në mbi 800 euro për një punonjës të vetëm.

Sindikata paralajmëron: Ose dialog, ose veprime sindikale

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj,

thotë se vendimi për ta përgjysmuar shtesën për përvojën e punës është bërë në kundërshtim me kërkesat e sindikatës. “Ne e patëm bërë një kërkesë tjetër gjatë përgatitjes së Ligjit për Paga. Patëm kërkuar që dhjetë vjetët e parë të paguhen 0.5 %, pastaj dhjetë vjetët e tjerë 0.75 % dhe ata që kanë përvojë 30 vjet e më shumë të paguhen me 1 %”, thotë ai. Por, kërkesa e tyre nuk u mor parasysh dhe shtesa e përvojës vetëm u reduktua. Jasharaj shpreh zhgënjim nga mungesa e dialogut me institucionet, që thotë se e ka përkeqësuar situatën dhe e ka rritur pakënaqësinë te punonjësit. “Anëtarësia jonë na jep dy detyra: ose të dialogojmë,

ose të veprojmë. Kur nuk kemi dialog për një kohë të gjatë, detyrohemi të ndërmarrim veprime sindikale, si protesta dhe greva”, thotë Jasharaj. Ai shton se, ndonëse në shikim të parë shumat mujore mund të duket e vogël, efekti i saj është i ndjeshëm. “Duket e vogël, por kur shikohet për gjithë ata muaj, shumat duket goxha e madhe, sidomos kur merren parasysh pagat e ulëta dhe inflacioni”, thotë Jasharaj për Radion Evropa e Lirë.

Kërkesa për zbatim dhe kompensim retroaktiv

Si Jakaj ashtu edhe Jasharaj kërkojnë që Kuvendi ta ndryshojë

Ligjin për Pagat në përputhje me aktgjykimin e Kushtetueses dhe ta sigurojë kthimin e mjeteve në mënyrë retroaktive. Mosveprimi, sipas tyre, jo vetëm që ka prodhuar dëm financiar, por rrezikon të krijojë kosto shtesë për shtetin përmes proceseve gjyqësore. Edhe vetë mësimdhënësi Hajdini do të pëlqente që zgjidhja të mos vinte nga gjykatat. “Dihet që ky vendim ka qenë i gabuar. Do të ishte më mirë që qeveria vetë ta bëjë këtë ndryshim dhe të mos shkohet përmes gjykatave”, thotë ai. Qeveria e Kosovës nuk u përgjigj në pyetjen e REL-it se a do t'i kompensojë punëtorët për paratë që kanë humbur deri më tani.

Arsim Bajrami promovon librin "Konferenca e Rambujesë dhe intervenimi i NATO-s në Kosovë"

PRISHTINË, 18 MARS - Në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) të mërkurën, në një atmosferë të veçantë akademike dhe me një pjesëmarrje të jashtëzakonshme të studiuesve dhe dashamirëve të librit, është bërë përurimi i veprës së akademik Arsim Bajramit, me titull "Konferenca e Rambujesë dhe intervenimi i NATO-s në Kosovë".

Ky përurim nuk ishte vetëm një ngjarje promovuese, por një moment reflektimi kolektiv mbi një nga kapitujt më vendimtarë të historisë sonë kombëtare.

Në këtë vepër trajtohen me qasje analitike dhe dokumentare zhvillimet që lidhen me Konferencën e Rambujesë si një fitore e rëndësishme politike dhe diplomatike e çështjes së Kosovës, si dhe me intervenimin e NATO-s, i cili, përtej debateve mbi legjitimitetin dhe legalitetin ndërkombëtar, kishte karakter të theksuar humanitar dhe u bë faktor kyç në ndaljen e tragjedisë humanitare dhe në hapjen e rrugës drejt lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. "Prania e madhe në këtë përurim dëshmon jo vetëm interesimin për trajtimin shkencor të këtyre ngjarjeve, por edhe nevojën e vazhdueshme

për të dokumentuar dhe interpretuar drejt historinë tonë të afërt, në funksion të së vërtetës dhe të së ardhmes së shtetit tonë. Me këtë rast, shpreh mirënjohjen time më të sinqertë dhe të thellë për të gjithë pjesëmarrësit që nderuan këtë ngjarje me praninë e tyre. Falënderoj në mënyrë të veçantë recensentët për vlerësimin profesional dhe kontributin e tyre shkencor, lektorin për përkushtimin në përpunimin e tekstit, si dhe Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës për mbështetjen institucionale dhe botimin e kësaj vepre", ka thënë para të



pranishmëve autori i këtij libri, Arsim Bajrami.

Ai ka theksuar e ky libër është një përpjekje modeste për të

kontribuar në ndriçimin e së vërtetës historike dhe për ta ruajtur kujtesën kolektive mbi rrugëtimin tonë drejt lirisë.

DREJTËSIA NDËRKOMBËTARE NUK MUND TA RREZIKOJË KREDIBILITETIN E UÇK-së DHE TË NATO-s NË KOSOVË!

- UÇK dhe NATO: Simbole absolute të çlirimit, stabilitetit dhe drejtësisë ndërkombëtare



Shkruan:
Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

UÇK - trashëgimia morale dhe historike që nuk diskutohet

UÇK-ja nuk ishte thjesht një forcë ushtarake. Ajo është manifestim i aspiratës shekullore të popullit shqiptar për liri, dinjitet dhe vetëvendosje. Çdo përpjekje për ta relativizuar këtë legjitimitet është sulm ndaj historisë dhe identitetit kombëtar. Veprimtaritë e UÇK-së, brenda një konteksti ndërkombëtar të njohur dhe në kuadër të normave të të drejtës për vetëmbrojtje, kanë pasur si

qëllim: mbrojtjen e popullatës civile, ndalimin e krimeve masive dhe pastrimeve etnike, konsolidimin e themelit të shtetit modern të Kosovës. Fakti historik dhe legjitimiteti moral janë të pakontestueshëm dhe duhet të mbrohen si pjesë integrale e historisë botërore të luftës për liri dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare.

NATO - garancia ndërkombëtare e paqes dhe stabilitetit

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë nuk ishte thjesht një operacion ushtarak; ajo ishte manifestim i qartë i parimit të ndërhyrjes humanitare nën Kapitullin VII të Kartës së OKB-së. Qëllimi i ndërhyrjes nuk ishte vetëm forcimi i sigurisë, por edhe mbrojtja e normave ndërkombëtare, parandalimi i katastrofave humanitare dhe vendosja e një rendi të qëndrueshëm rajonal.

Çdo tentativë për të relativizuar këtë rol do të dëmtonte: kredibilitetin e NATO-s si faktor stabiliteti, normat ndërkombëtare që garantojnë sigurinë dhe paqen, besimin global në mekanizmat ndërkombëtarë të drejtësisë.

Pa besueshmërinë dhe legjitimitetin e NATO-s, rendi ndërkombëtar është në rrezik të drejtpërdrejtë, sidomos në rajone post-konfliktuale ku stabiliteti është ende delikat.

Rreziku i interpretimeve selektive

Interpretimet njëanshme ose selektive të veprimeve historike nuk prodhojnë drejtësi; ato prodhojnë: tensione politike, krizë legjitimiteti për institucionet ndërkombëtare, destabilitet afatgjatë në rajone të ndjeshme. Kosova nuk ka qenë vetëm një skenë konflikti; ajo ka qenë proces i shenjtë i çlirimit dhe

konsolidimit shtetëror, ku veprimet e UÇK-së dhe ndërhyrja e NATO-s shpëtuan jetë, ndaluan katastrofa humanitare dhe vendosën themelet e paqes, sigurisë dhe stabilitetit institucional.

Mesazhi për komunitetin ndërkombëtar - nuk ka kompromis me historinë

Institucionet ndërkombëtare, organet e drejtësisë dhe opinionet publike duhet të kuptojnë se çdo përpjekje për të relativizuar këto kontribute është kërcënim strategjik për stabilitetin rajonal dhe besueshmërinë ndërkombëtare. Drejtësia nuk mund të përdoret si: vegël politike, instrument selektiv, apo mekanizëm për interpretim njëanshëm të historisë. Ajo duhet të veprojë si mburojë e së vërtetës, e drejtës historike dhe e besueshmërisë ndërkombëtare, duke garantuar

që legjitimiteti i aktorëve kryesorë të mbetet i pakontestueshëm.

Paqja dhe stabiliteti nuk diskutohen

Kush cenon kredibilitetin e UÇK-së ose NATO-s, rrezikon paqen, stabilitetin dhe të ardhmen e Ballkanit Perëndimor.

Vetëm një qasje e balancuar, historikisht e informuar dhe e matur mund të sigurojë: drejtësinë ndërkombëtare të drejtë dhe efektive, ruajtjen e legjitimitetit historik dhe moral të aktorëve kryesorë, konsolidimin e stabilitetit rajonal të pandashëm. Mesazhi është i qartë: Historia, ligji dhe drejtësia nuk tolerojnë manipulime ose interpretime të pjesshme. Çdo cenim ndaj këtyre parimeve nuk është vetëm gabim historik, por rrezik real për paqen, sigurinë dhe stabilitetin e rajonit dhe botës.

Përfundon afati i ftesës/thirrjes për dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese

PRISHTINË, 18 MARS - Të martën, më 17 mars, ka përfunduar afati i ftesës/thirrjes publike për dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Për këto dy pozita kanë aplikuar 25 kandidatë: Vigan Rogova, Zahir Çerkini, Besard Belegu, Makfirete Krasniqi, Selman Ymeri,

Avdyllkadër Muçaj, Elton Tota, Benina Kusari, Ramadan Gashi, Shabi Idrizi, Rafet Haxhaj, Valbona Shala Thaqi, Shpresa Emra, Suzana Gashi, Ardita Haxhnikaj Demi, Novitet Nezaj, Alban Muriqi, Flamur Mrasori, Emine Abdyli Pozhari, Përparim Kalo, Nazmije Krasniqi Jusufi, Riza

Krasniqi, Jorida Xhafaj, Islam Sllamniku dhe Bahrije Zaçaj. Administrata është në pritje të nominimeve eventuale nëpërmjet postës. Procedura e përzgjedhjes së gjyqtarëve do të vazhdojë në përputhje me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.



RASTI I PESËVJEÇARIT NË LIPJAN: KOMF-i DHE UNICEF-i KËRKOJNË HETIM INSTITUCIONAL DHE FORCIMIN E SISTEMEVE TË MBROJTJES SË FËMIJËVE

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 MARS - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) ka shprehur shqetësim të thellë lidhur me rastin e rëndë të fëmijës pesëvjeçar nga komuna e Lipjanit, i cili është sjellë në QKUK në gjendje kritike shëndetësore dhe psikologjike si pasojë e dyshimeve për neglizhencë dhe keqtrajtim ekstrem nga prindërit. Në momentin e pranimit, fëmija ishte në gjendje të rënduar, me dyshime për kequshqyerje dhe vështirësi në komunikim.

Menjëherë pas pranimit në Emergjencën Qendrore janë realizuar konsultat nga kirurgu plastik dhe pediatri, të cilët kanë rekomanduar hospitalizimin urgjent të fëmijës në Klinikën e Pediatriisë, përkatësisht në repartin e Kujdesit Intensiv Pediatrik për trajtim të mëtejme. Për shkak të dyshimeve për keqtrajtim të mundshëm, janë njoftuar Policia dhe punëtorët socialë në përputhje me procedurat ligjore.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) ka theksuar se, sipas të dhënave të institucioneve, kjo familje ishte rast i njohur për institucionet prej katër vitesh. “Ky rast, edhe një herë, shfaq dështimin e institucioneve në mbrojtjen e fëmijëve dhe ngrit shqetësime serioze për funksionimin dhe reagimin në kohë të mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e tyre. Shteti ka obligim ligjor të jetë mburoja e parë e fëmijës kur familja dështon. KOMF kërkon hetim të plotë institucional, duke përfshirë hetimin e gjithë zinxhirit të institucioneve të përfshira në rast dhe marrjen e masave të menjëhershme në përputhje



me të gjeturat, duke siguruar llogaridhënie dhe përgjegjësi institucionale”, thuhet në reagimin e KOMF-it, duke theksuar se ky rast rikonfirmon nevojën urgjente për reforma rrënjësore dhe investime të menjëhershme në sistemin e mbrojtjes sociale. “KOMF kërkon fuqizimin e kapaciteteve përmes rritjes së numrit të punonjësve socialë dhe profileve të tjera profesionale në Qendrat për Punë Sociale, në mënyrë që asnjë rast të mos mbetet pa trajtimin e duhur. Është jetike që institucionet të zhvillojnë programe të mirëfillta për fuqizimin e familjeve në krizë dhe të ofrojnë shërbime sociale e familjare që parandalojnë eskalimin e rasteve të tilla përpara se të jetë tepër vonë”, është thënë në këtë reagim.

KOMF-i u bënë thirrje të gjithë qytetarëve që të mos qëndrojnë indiferentë. Mbrojtja e fëmijëve është përgjegjësi kolektive. “Çdo dyshim për dhunë, neglizhencë apo keqtrajtim sipas legjislacionit në fuqi duhet të raportohet menjëherë tek Policia e Kosovës apo

Qendra për Punë Sociale. Raportimi në kohë, mund të jetë kufiri i vetëm që ndan jetën nga vdekja për një fëmijë në rrezik”, theksohet në reagimin e KOMF-it.

Edhe UNICEF-i në Kosovë përmes një reagimi ka theksuar se asnjë fëmijë nuk duhet të përfetojë dhunë, frikë apo neglizhencë, sidomos brenda shtëpisë së tij, e cila duhet të jetë një vend sigurie, kujdesi dhe mbrojtjeje. “Dhuna ndaj fëmijëve është një shkelje e rëndë e të drejtave të tyre dhe ka pasojë afatgjatë fizike he psikologjike. Ky rast pasqyron një shkelje serioze të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF), e cila garanton mbrojtjen e çdo fëmije nga dhuna, abuzimi dhe neglizhenca (Neni 19), si dhe të drejtën për mbijetesë, zhvillim dhe dinjitet. KDF është direkt e zbatueshme në Kushtetutën e Kosovës, e cila i jep instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut prioritet mbi ligjet vendore. Kjo vendos një detyrim të qartë ligjor mbi të gjitha institucionet për të parandaluar, identifikuar dhe

për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive rasteve të dhunës dhe neglizhencës ndaj fëmijëve. Ky rast tregon nevojën urgjente për të forcuar sistemet e mbrojtjes së fëmijëve, për të siguruar identifikimin e hershëm të fëmijëve në rrezik në shëndetësi, arsim dhe shërbime sociale, si dhe për të ofruar mbështetje të shpejtë familjeve të cënueshme për të parandaluar dhunën. Menaxhimi i koordinuar i rasteve në nivel komunal, shërbimet e funksionimit të plotë të mbrojtjes së fëmijëve dhe financimi i qëndrueshëm janë thelbësore për të parandaluar dhe për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive dhunës ndaj fëmijëve”, është theksuar në reagimin e UNICEF-it.

Pesëvjeçarit i janë operuar shputat, gjendja e tij është stabile

Klinika e Pediatriisë ka njoftuar të mërkurën se pacienti 5 vjeç, i hospitalizuar aktualisht në Kujdesin Intensiv Pediatrik, i

është nënshtruar intervenimit të nevojshëm kirurgjik në nivel të shputave nga ekipet specialiste të Ortopedisë dhe Kirurgjisë Plastike. “Intervenimi sapo ka përfunduar dhe është realizuar sipas indikacioneve mjekësore. Gjatë procedurës kirurgjikale, gjendja e pacientit ka qenë stabile. Pas përfundimit të intervenimit, pacienti është transferuar në Kujdesin Intensiv Pediatrik, ku po vazhdon trajtimin, mbikëqyrjen dhe përkujdesjen e mëtejme postoperative. Për shkak të ndjeshmërisë së rastit, ky është informacioni që aktualisht mund të ofrohet. Për çdo përditësim të mëtejme lidhur me gjendjen e pacientit, mediat dhe publiku do të njoftohen në vijim vetëm përmes Zyrës për Informim pranë SHSKUK-së. Njëkohësisht, theksojmë se ekipet profesionale shëndetësore janë duke ofruar përkujdesje maksimale dhe trajtimin e nevojshëm në përputhje me protokollet mjekësore. Për këtë arsye, lusim mediat që të kenë mirëkuptim dhe të shmangin presionet për informata shpesh, kërkesa për intervista apo forma të tjera të komunikimit të drejtpërdrejtë, pasi çdo informacion zyrtar nga Klinika e Pediatriisë do të përcillet vetëm përmes Zyrës për Informim pranë SHSKUK-së”, ka njoftuar Klinika e Pediatriisë. Një ditë më parë fëmija u vizitua edhe nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, për ta parë nga afër gjendjen shëndetësore. Po në koordinim me ministrin e Ministrisë së Punës, Familjes dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti dhe me Qendrën për Punë Sociale në komunën e Lipjanit, pritet të merren të gjitha hapat e nevojshëm për mbrojtje ligjore dhe sociale.

BIK-u: Namazi i Fitër Bajramit falet të premten në orën 06:18

PRISHTINË, 18 MARS - Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka njoftuar besimtarët dhe opinionin e gjerë se muaji i madhëruar i Ramazanit përfundon ditën e enjte, më 19 mars 2026. Dita e parë e festës së Fitër Bajramit është të premten, më 20 mars 2026. Manifestimi qendror për festën e Fitër Bajramit në Republikën e Kosovës do të mbahet në Xhaminë e Madhe në Prishtinë.

Programi fillon në orën 05:03 me faljen e namazit të sabahut, pas të cilit do të mbahet ligjëratat tematike kushtuar kësaj feste nga kryeimami i KBI-së në Ferizaj, Ibrahim ef. Beqiri. Namazi i Fitër Bajramit falet në orën 06:18, të cilit do t’i prijë kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti. Hytben e Fitër Bajramit do ta mbajë Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili do t’i drejtohet opinionit të gjerë me mesazhin

e kësaj feste. Me rastin e festës së Fitër Bajramit, ditën e parë, më 20 mars 2026, Kryesia e BIK-ut, sipas traditës, organizon pritje urimi në selinë e saj nga ora 09:00 deri në orën 12:00. Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ua ka uruar festën e Fitër Bajramit të gjithë besimtarëve dhe opinionit të gjerë, duke e lutur Zotin t’i ketë pranuar agjërimin, lutjet dhe ibadetet tona.



Zyrtarë të ARBK-së merren në pyetje nën dyshimin për keqpërdorim të detyrës

PRISHTINË, 18 MARS - Autoritetet në Kosovë i kanë marrë në pyetje disa zyrtarë të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) të mërkurën si pjesë e një aksioni ndaj agjencisë lidhur me dyshimet për keqpërdorimin e detyrës dhe falsifikimin e dokumenteve.

Ushtruesja e detyrës së kryeshefe të ARBK-së, Igballe Rexha-Jashari, si dhe dy zyrtarë të tjerë janë shoqëruar për në stacionin policor për t'u marrë në pyetje, tha për Radion Evropë e Lirë zëdhënësja e

Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kaltrina Shala. Paraprakisht Prokuroria Themelore në Prishtinë njoftoi se bastisja në ARBK po zhvillohej për shkak të dyshimeve për kryerjen e veprave penale: keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve.

Në një përgjigje për Radion Evropë e Lirë, Shala nuk ka treguar se cilat janë funksionet e zyrtarëve të tjerë. “Prokurori do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore në lidhje me

rastin”, tha ajo.

Autoritetet nuk kanë dhënë më shumë hollësi rreth keqpërdorimeve të dyshuara në këtë agjenci.

ARBK-ja është institucioni kryesor për regjistrimin dhe administrimin e bizneseve në Kosovë dhe vepron nën Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Në një reagim më vonë, MINT tha se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vendimeve gjyqësore relevante, “stafi i ARBK-së ka konstatuar muaj më parë se kishte



ndodhur një keqinterpretim i një aktgjykimi gjyqësor”. “Si rrjedhojë, ky interpretim është

korrigjuar përmes procedurave përkatëse ligjore dhe administrative”, tha ajo.

NËNSHKRUHET KREDIA 80 MILIONË EURO PËR REFORMAT NË SEKTORIN E ENERGJISË



PRISHTINË, 18 MARS - Kosova ka nënshkruar me Bankën Zhvillimore Gjermane (KfW) kredinë në vlerë prej 80 milionë eurosh për t'i mbështetur reformat në sektorin e energjisë dhe politikave klimatike. Kjo kredi është firmosur nga ministri i Financave, Hekuran Murati dhe përfaqësuesi i KfW-së, Pablo Obrador Alvarez.

Ministri Murati ka thënë se kjo kredi do të shërbejë si mbështetje buxhetore për reformat e parashikuara në kuadër të integritimit energjetik me rajonin dhe shtetet e tjera të Bashkimit Evropian. “Bëhet fjalë për një mbështetje financiare në vlerën

prej 80 milionë eurosh, e cila do të shërbejë si mbështetje buxhetore për reformat e parashikuara në kuadër të integritimit energjetik me rajonin dhe shtetet e tjera të Bashkimit Evropian. Këto reforma na afrojnë më shumë drejt konvergjit, si në politika, ashtu edhe në përgatitjen e sistemit tonë energjetik, për të garantuar të drejta të plota në ENTSO-E dhe për integrimin në të gjithë sistemin energjetik rajonal e më gjerë. Kjo është një mbështetje e jashtëzakonshme për të cilën i jemi falënderues shtetit gjerman dhe bankës KfW. Besoj se bashkëpunimi ynë do të

vazhdojë edhe më tutje, sidomos në fushën e energjisë, por edhe në fusha të tjera”, ka thënë Murati.

Ndërsa Pablo Obrador Alvarez nga KfW-ja ka thënë se kjo është kredia e parë e bazuar në politika që nënshkruhet me Kosovën. Ai ka theksuar se instrumenti synon ta plotësojë financimin e projekteve të mëdha infrastrukturore në sektorin e energjisë, duke mbështetur qeverinë në zbatimin e reformave të nevojshme për tranzicionin energjetik. “Shpresojmë që në vitet e ardhshme të realizojmë së bashku reformat e parashikuara në këtë program”, ka thënë Alvarez.

BQK-ja THEKSON RËNDËSINË E EDUKIMIT FINANCIAR NË NDARJEN E ÇMIMEVE TË GARËS PËR BANKIERË TË RINJ

PRISHTINË, 18 MARS - Banka Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) si bashkorganizatore me Shoqatën e Bankave të Kosovës dhe me mbështetjen e German Sparkassenstiftung for International Cooperation, organizuan ceremoninë e ndarjes së çmimeve për garën “Stock Market Learning Competition” për bankierë të rinj, si pjesë e organizimeve të përbashkëta dhe dakorduara sipas Memorandumit të Mirëkuptimit me shoqatat e sektorit financiar. Në këtë aktivitet zëvendësguvernatorja e BQK-së, Nesrin Shileku-Shala, theksoi rëndësinë e edukimit financiar dhe të

përvijës praktike në përgatitjen e profesionistëve të rinj për sfidat e tregut financiar. Ajo nënvizoi përkushtimin e vazhdueshëm të BQK-së në forcimin e edukimit financiar, mbrojtjes së konsumatorit dhe përfshirjes financiare, duke e reflektuar këtë angazhim edhe përmes aktiviteteve të organizuara në kuadër të Javës Globale të Parasë. Përmes kësaj gare pjesëmarrësit patën mundësinë t'i thellojnë njohuritë e tyre mbi funksionimin e tregjeve të kapitalit dhe të zhvillojnë aftësi praktike në vendimmarrje investuese në një mjedis simulues të tregtimit. Një ditë më parë, me rastin e

hapjes së Javës Globale të Parasë, BQK shpalli fituesit e kësaj gare për studentët me një ceremoni të veçantë ku u shpërblyen 11 fitues.

Zëvendësguvernatorja Shileku-Shala gjithashtu rikonfirmoi fokusin strategjik të BQK-së në zhvillimin e tregjeve të kapitalit në përpunje me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

BQK-ja ka theksuar se mbetet e përkushtuar në promovimin e edukimit financiar dhe në ndërtimin e një shoqërie financiarisht të edukuar dhe të qëndrueshme.



Spanca takon ministrin Muja, diskutojnë për çështjet dhe rekomandimet e ZKA-së

PRISHTINË, 18 MARS - Auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, e shoqëruar nga zëvendësauditori i përgjithshëm, Beza Halilaj, u pritën në takim nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Armend Muja. Takimi pati për qëllim njohjen më të afërt me çështjet dhe rekomandimet e Zyrës Kombëtare

të Auditimit si dhe adresimin e tyre në funksion të përmirësimit të fushave dhe proceseve që mbulohen nga kjo ministri. Spanca e informoi Mujën për çështjet e identifikuar nga auditimet e kryera si dhe theksoi domosdoshmërinë e adresimit të rekomandimeve përkatëse në ministri dhe agjencitë vartëse të

saj.

Ndërsa ministri Armend Muja shprehu gatishmërinë për t'i trajtuar dhe adresuar këto çështje, duke vlerësuar njëkohësisht kontributin e ZKA-së për përmirësimin e menaxhimit të parasë dhe pasurisë publike në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.



AGIMI I SHOQËRISË POST-SHKRIM-LEXIM

Nga: James MARRIOTT / jmarriott.substack.com

Epoka e shtypit

Ishte një nga revolucionet më të rëndësishme në historinë moderne - dhe megjithatë nuk u derdh asnjë pikë gjaku, nuk u hodhën bombat dhe nuk u pre koka e asnjë monarku.

Ndoshta asnjë transformim i madh shoqëror nuk është kryer kurrë kaq qetë. Ky ndodhi në kolltukë, në biblioteka, në kafene dhe në klube.

Ja çfarë ndodhi: në mesin e shekullit të tetëmbëdhjetë, një numër i madh njerëzish të zakonshëm filluan të lexonin.

Në dy shekujt e parë pas shpikjes së shtypshkronjës, leximi mbeti kryesisht aktivitet i elitës. Por, në fillim të viteve 1700, zgjerimi i arsimit dhe shpërthimi i botimeve të lira bënë që leximi të përhapej me shpejtësi nëpër shtresat e mesme dhe madje edhe në shtresat më të ulëta të shoqërisë. Njerëzit që jetonin në atë kohë e kuptonin se po ndodhte diçka e jashtëzakonshme. Papritmas dukej sikur të gjithë po lexonin kudo: burra, gra, fëmijë, të pasur dhe të varfër. Leximi filloi të përshkruhej si “ethe”, “epidemi”, “mani”, “çmenduri”. Siç shkruan historiani Tim Blanning, “konservatorët u tmerruan dhe progresistët u gëzuan sepse ishte një zakon që nuk i njihte kufijtë shoqërorë”.

Ky transformim nganjëherë quhet “revolucion i leximit”. Ishte një demokratizim i paprecedentë i informacionit; transferimi më i madh i dijes në duart e njerëzve të zakonshëm në histori.

Në Britani vetëm 6 000 libra u botuan në dekadën e parë të shekullit të tetëmbëdhjetë; në dekadën e fundit të të njëjtit shekull numri i titujve të rinj kalonte 56 000. Më shumë se gjysmë milion botime të reja u shfaqën në gjuhën gjermane gjatë viteve 1700. Historiani Simon Schama ka shkruar deri aty sa të shkruajë se “niveli i shkrim-leximit në Francën e shekullit të tetëmbëdhjetë ishte shumë më i lartë se në Shtetet e Bashkuara në fund të shekullit të njëzetë”.

Dikur lexuesit lexonin “në mënyrë intensive”, duke kaluar jetën duke lexuar dhe rilexuar dy ose tre libra. Revolucion i leximit popullarizoi një formë të re leximi “ekstensiv”. Njerëzit lexonin gjithçka që mund të gjenin: gazeta, revista, histori, filozofi, shkencë, teologji dhe letërsi. Libra, pamflete dhe periodikë dilnin me shumicë nga shtypshkronjat.

Ishte një epokë e veprave monumentale të mendimit dhe dijes:

Enciklopedia [Encyclopédie], Fjalori i gjuhës angleze [Dictionary of the English Language] i Samuel Johnson, Rënia dhe shkatërrimi i Perandorisë Romake [Decline



and Fall of the Roman Empire] i Edward Gibbonit, Kritika e arsyes së pastër [Kritik der reinen Vernunft] e Immanuel Kantit. Ide të reja radikale për Zotin, për historinë, për shoqërinë, për politikën dhe madje për qëllimin dhe kuptimin e jetës përhapeshin në gjithë Evropën.

Edhe më me rëndësi, shtypi ndryshoi mënyrën se si njerëzit mendonin. Bota e shtypit është e rregullt, logjike dhe racionale. Në libra, dija klasifikohet, kuptohet, lidhet dhe vendoset në vendin e vet. Librat ndërtojnë argumente, propozojnë teza, zhvillojnë ide.

“Të angazhohesh me fjalën e shkruar”, ka shkruar teoricieni i mediaeve Neil Postman, “do të thotë të ndjekësh një vijë mendimi, gjë që kërkon aftësi të konsiderueshme për klasifikim, nxjerrje përfundimesh dhe arsyetim”.

Siç vuri në dukje Postmani, nuk është rastësi që rritja e kulturës së shtypit në shekullin e tetëmbëdhjetë u shoqërua me rritjen e prestigjit të arsyes, me armiqësinë ndaj besëtytnive, me lindjen e kapitalizmit dhe me zhvillimin e shpejtë të shkencës. Historianë të tjerë e kanë lidhur shpërthimin e shkrim-leximit me shekullin e tetëmbëdhjetë me Iluminizmin, me lindjen e të drejtave të njeriut, me ardhjen e demokracisë dhe madje me fillimet e revolucionit industrial. Bota, siç e njohim sot, u farkëtua në revolucionin e leximit.

Kundërrevolucion

Tani, ne po jetojmë përgjatë kundërrevolucionit.

Më shumë se treqind vjet pasi revolucion i leximit solli një epokë të re të dijes njerëzore, librat po zhduken.

Studimet e shumta tregojnë se

leximi është në rënie të lirë. Edhe kritikët më pesimistë të shekullit të njëzetë, ndaj epokës së ekraneve, do ta kishin pasur të vështirë të parashikonin përmasat e krizës së sotme.

Në Shtetet e Bashkuara, leximi për kënaqësi ka rënë me 40 për qind gjatë njëzet vjetëve të fundit. Në Mbretërinë e Bashkuar, më shumë se një e treta e të rriturve thonë se kanë hequr dorë nga leximi. Fondi Kombëtar i Shkrim-Leximit [National Literacy Trust] raporton një rënie “tronditëse dhe demoralizuese” në lexim nga fëmijët që tani është në nivelin më të ulët të regjistruar ndonjëherë. Industria e botimeve është në krizë: siç shkruan autori Alexander Larman, “librat që dikur do të shiteshin në dhjetëra, madje qindra mijëra kopje, sot janë me fat nëse arrijnë të shiten në disa mijëra”.

Edhe më domethënëse, në fund të vitit 2024, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik [OECD] publikoi një raport që zbuloi se nivelet e shkrim-leximit po bien ose po stagnonin në shumicën e vendeve të zhvilluara. Dikur një sociolog që do të përballej me statistika të tilla mund të kishte menduar se shkak për këtë ishte një krizë e madhe shoqërore, si lufta apo kolapsi i sistemit arsimor.

Por, ajo që ndodhi ishte smartfoni [smartphone], i cili u përhap gjerësisht në vendet e zhvilluara në mesin e viteve 2010. Ato vite do të kujtohen si pikë kthese në historinë njerëzore.

Asnjëherë më parë nuk ka ekzistuar një teknologji si smartfoni. Ndërsa teknologjitë e mëparshme të argëtimit, si kinemaja apo televizioni, synonin të mbanin vëmendjen e publikut për një periudhë kohe, smartfoni kërkon gjithë jetën

tënde. Telefonat janë projektuar që të jenë hiper-varësi, duke i mbërthyer përdoruesit në një mori njoftimesh të panevojshme, videosh të shkurtra pa kuptim dhe provokimesh emocionale në rrjetet sociale.

Sot, një person mesatar kalon shtatë orë në ditë duke parë ekranin. Për Gjeneratën Z, shifra është nëntë orë. Një artikull i fundit në The Times zbuloi se studentët modernë mesatarisht janë të destinuar të kalojnë 25 vjet të jetës së tyre zgjuar duke bërë lëvizje me gisht në ekrane. Nëse revolucion i leximit përfaqësonte transferimin më të madh të dijes në duart e njerëzve të zakonshëm në histori, revolucion i ekraneve përfaqëson vjedhjen më të madhe të dijes nga njerëzit e zakonshëm në histori.

Universitetet tona janë në vijën e parë të kësaj krize. Ato po mësojnë tani brezat e parë vërtet “post-shkrim-lexim” të studentëve, të cilët janë rritur pothuajse tërësisht në botën e videove të shkurtra, lojërave kompjuterike, algoritmeve që krijojnë varësi (dhe, gjithnjë e më shumë, IA-së - inteligjencës artificiale).

Për shkak se interneti celular i kudondodhur ka shkatërruar aftësinë e tyre për përqendrim dhe ka kufizuar zhvillimin e fjalorit të tyre, dija e pasur dhe e detajuar që ruhet në libra po bëhet e paarritshme për shumë prej tyre. Një studim mbi studentët e letërsisë angleze në universitetet amerikane zbuloi se ata nuk ishin në gjendje të kuptonin paragrafin e parë të romanit Shtëpia e shkretë [Bleak House] të Charles Dickensit - libër që dikur lexohej rregullisht nga fëmijët.[1]

Një artikull i botuar në The Atlantic, me titull “Studentët e

kolegjeve elitare që nuk mund të lexojnë libra”, citon përvojën tipike të një profesori:

Njëzet vjet më parë, klasat e [Nicholas] Damesit nuk kishin asnjë problem të zhvillonin diskutime të sofistikuar - një javë për [librin] Krenari dhe paragjykim [Pride and Prejudice] dhe javën tjetër për Krim dhe ndëshkim [Prestuplenie i nakazanie]. Tani studentët e tij i thonë që në fillim se ngarkesa e leximit u duket e pamundur. Nuk është vetëm ritmi i shpejtë; ata kanë vështirësi të përqendrohen te detajet e vogla duke mbajtur njëkohësisht në mendje rrjedhën e përgjithshme të ngjarjeve.

Sipas një vlerësimi tjetër dëshpërues, shumica e studentëve tanë janë praktikisht analfabetë “funksionalë”. Kjo përputhet me gjithçka që kam dëgjuar në bisedat e mia me mësues dhe studiues. Një pedagog i Oksbrixhit me të cilin fola, e përshkroi situatën si “kolaps të shkrim-leximit” te studentët e tij.

Bartja e dijes - funksioni më i lashtë i universitetit - po shpërbëhet para syve tanë. Autorë si Shakespeare, Milton dhe Jane Austen, veprat e të cilëve janë bartur brez pas brezi ndër shekuj, nuk po arrijnë më te brezi i ardhshëm i lexuesve. Ata po humbasin aftësinë për t'i kuptuar.

Tradita e mësimit është si një fije e çmuar e artë e dijes që përshkon historinë njerëzore, duke lidhur nëpër kohë lexues me lexues. Ajo u këput për herë të fundit gjatë rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit, kur valët barbare goditnin kufijtë, qytetet tkurrëshin dhe bibliotekat digjeshin ose kalbeshin.[2] Ndërsa bota e elitës së arsimuar romake shpërbëhej, shumë shkrimtarë dhe vepra letrare

dolën nga kujtesa njerëzore - disa për t’u humbur përgjithmonë, të tjerat për t’u rizbuluar qindra vjet më vonë gjatë Rilindjes. Kjo fije e artë po këputet për herë të dytë.

Një tragjedi intelektuale

Rënia e leximit po shkakton ulje në tregues të ndryshëm të aftësive njohëse. Leximi lidhet me një sërë përfitimesh mendore, përfshirë përmirësimin e kujtesës dhe përqendrimin, aftësi më të mira analitike, rrjedhshmëri më të madhe në të shprehur dhe ritme më të ulëta të rënies kognitive në moshë të shtyrë. Pas përhapjes së smartfonëve në mesin e viteve 2010, rezultatet globale të PISA-s - matja më e njohur ndërkombëtare e aftësive të nxënësve - filluan të bien. Siç shkruan John Burn-Murdoch në Financial Times, studentët gjithnjë e më shpesh thonë në sondazhe se kanë vështirësi të mendojnë, të mësojnë dhe të përqendrohen. Do të vini re pikën karakteristike të kthesës në mesin e viteve 2010. Studimi Monitorimi i së ardhmes [Monitoring the Future] ka pyetur 18-vjeçarët nëse kanë vështirësi të mendojnë, të përqendrohen ose të mësojnë gjëra të reja. Përqindja e maturantëve që raportojnë vështirësi mbeti e qëndrueshme gjatë viteve 1990 dhe 2000, por filloi të rritej me shpejtësi në mesin e viteve 2010.

Dhe, siç thotë Burn-Murdoch, këto probleme njohëse nuk kufizohen vetëm në shkolla dhe universitete. Ato prekin të gjithë: “Rënia në aftësitë e arsyetimit dhe zgjidhjes së problemeve nuk kufizohet te adoleshentët. Edhe të rriturit tregojnë një model të ngjashëm, me rënie të dukshme në të gjitha grupmoshat”. Më intriguese - dhe njëkohësisht alarmante - është rasti i koeficientit të inteligjencës [IQ] që u rrit vazhdimisht gjatë gjithë shekullit të njëzetë (si ashtuquajtur i “efekti Flynn”), por që tani duket se ka filluar të bjerë. Rezultati nuk është vetëm humbja e informacionit dhe e inteligjencës, por edhe një varfërim tragjik i përvojës njerëzore. Për shekuj me radhë, pothuajse të gjithë njerëzit e arsimuar dhe inteligjentë kanë besuar se letërsia dhe dija janë ndër qëllimet më të larta dhe ngushëllimet më të thella të ekzistencës njerëzore. Veprat klasike janë ruajtur ndër shekuj sepse përmbajnë, sipas shprehjes së famshme të Matthew Arnoldit, “më të mirën që është menduar dhe thënë ndonjëherë”. Romanet dhe poezitë më të mëdha pasurojnë kuptimin tonë për përvojën njerëzore duke na vendosur në mënyrë imagjinare brenda mendjeve të të tjerëve dhe duke na çuar në kohë dhe vende të tjera. Duke lexuar vepra joletrare - shkencë, histori, filozofi, udhëpërshkrime - ne bëhemi thellësisht të vetëdijshëm për vendin tonë në botën e jashtëzakonshme dhe të ndërlikuar që kemi privilegjin të banojmë.

Smartfonët po na i rrëmbejnë këto ngushëllime.

Epidemia e ankthit, depresionit dhe mungesës së qëllimit që po prek të rinjtë në shekullin e njëzet e një shpesh lidhet me izolimin dhe krahasimin negativ shoqëror që nxisin smartfonët. Por, ajo është gjithashtu produkt i drejtpërdrejtë i kotësisë, fragmentimit dhe trivialitetit të kulturës së ekranit, e cila është krejtësisht e paaftë t’u përgjigjur ndaj nevojave të thella njerëzore për kureshtje, rrëfim, përqendrim të thellë dhe përmbushje artistike.

Një botë pa mendje

Ky shterim i kulturës, i mendimit kritik dhe i inteligjencës përfaqëson një humbje tragjike të potencialit njerëzor dhe të lulëzimit njerëzor. Është gjithashtu një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen shoqëritë moderne. Qytetërimi ynë i gjerë, i ndërlikur, tolerant dhe i avancuar në aspektin teknik është ndërtuar mbi format komplekse dhe racionale të të menduarit që ushqen shkrim-leximi. Siç shkruan Walter Ong në librin e tij Oralja dhe shkrim-leximi [Orality and Literacy], disa forma të të menduarit kompleks dhe logjik thjesht nuk mund të arrihen pa lexim dhe shkrim. Është pothuajse e pamundur të zhvillosh një argument të detajuar dhe logjik vetëm përmes të folurit spontan - do të humbje fillin e mendimit, do të kundërshtojë veten dhe do të ngatërroje dëgjuesit duke u përpjekur të riformulojë çështje të shprehura keq. Si shembull ekstrem, mendoni për dikë që përpiket thjesht të thotë me gojë një vepër të famshme filozofike. Për shembull, Kritika e arsyes së pastër e Kantit me 900 faqe, Traktati [Tractatus] i Ludwig Wittgensteinit, ose Qenia dhe hiçi [L’Être et le néant: Essai d’ontologie phénoménologique] nga Sartre. Do të ishte e pamundur. Dhe, po aq e pamundur për ta dëgjuar. Për të prodhuar veprën e tij të madhe, Kanti duhej t’i shkruante idetë e tij, t’i fshinte, t’i mendonte përsëri, t’i përpunonte dhe t’i rishkruante gjatë shumë viteve derisa ato të formonin një tërësi bindëse dhe logjike. Për ta kuptuar siç duhet librin, duhet ta kesh përpara që të mund të rilexosh pjesët që nuk i kupton, të kontrollosh lidhjet logjike dhe të reflektosh mbi pasazhet e rëndësishme derisa vërtet i përvetëson. Ky lloj mendimi i avancuar është i pandashëm nga leximi dhe shkrimi. Studiuesi i klasikëve, Eric Havelock, argumentonte se ardhja e shkrim-leximit në Greqinë e lashtë ishte katalizatori për lindjen e filozofisë. Sapo njerëzit patën një mënyrë për t’i fiksuar idetë në faqe për t’i analizuar, për t’i përmirësuar dhe për t’i zhvilluar më tej, lindi një mënyrë krejtësisht e re revolucionare e mendimit analitik dhe abstrakt - një mënyrë që do të formësonte gjithë qytetërimin tonë.[3] Me lindjen e

shkrimit, mënyrat e pranuaara të të menduarit mund të sfidoheshin dhe të përmirësoheshin. Ky ishte çlirimi kognitiv i species sonë. Siç e tha Neil Postmani në Duke zbavitur veten deri në vdekje [Amusing Ourselves to Death]: Filozofia nuk mund të ekzistojë pa kritikë ... shkrimi e bën të mundur dhe të përshtatshme që mendimi të vihet nën një shqyrtim të vazhdueshëm dhe të përqendruar. Shkrimi e ngrin të folurin dhe duke e bërë këtë lind gramatikani, logjicieni, retoriku, historiani, shkencëtari - të gjithë ata që duhet ta mbajnë gjuhën përpara vetes për të parë se çfarë do të thotë, ku gabon dhe ku po shkon. Jo vetëm filozofia, por e gjithë infrastruktura intelektuale e qytetërimit modern varet nga format komplekse të të menduarit që janë të pandashme nga leximi dhe shkrimi: histori serioze, teorema shkencore, propozime të detajuara politike dhe debatet e rrepta e të paanshme politike që zhvillohen në libra dhe revista. Këto forma të mendimit të avancuar përbëjnë themelet intelektuale të modernitetit. Nëse bota jonë duket e paqëndrueshme sot - sikur toka po na lëkundet poshtë - kjo ndodh sepse ato themele po shemben nën këmbët tona. Siç mund ta keni vënë re, bota e ekranit do të jetë shumë më e trazuar sesa bota e shtypit: më emocionale, më e zemëruar dhe më kaotike. Walter Ong theksonte se shkrimi e ftoh dhe e racionalizon mendimin. Nëse doni të paraqisni argumentin tuaj personalisht ose në një video në TikTok, keni mënyra të panumërta për të anashkaluar argumentin logjik. Mund të bërtisni, të qani dhe të magjepsni audiencën derisa të nënshtrohet. Mund të përdorni muzikë emocionale ose të tregoni pamje tronditëse. Këto nuk janë argumente racionale, por njerëzit nuk janë qenie plotësisht racionale dhe shpesh binden prej tyre. Një libër nuk mund t’ju bërtasë (falë Zotit!) dhe nuk mund të qajë. Pa gamën e mjeteve që mund të mposhtin logjikën dhe që janë në dispozicion të podkasterëve dhe jutuberëve, autorët janë shumë më të varur vetëm nga arsyeja, të dënuar të ndërtojnë me dhimbje argumentet e tyre fjali pas fjalie (e ndiej atë agoni tani). Librat janë larg përsosmërisë, por janë shumë më të lidhur me kërkesat e argumentit logjik se çdo mjet tjetër komunikimi që njerëzimi ka shpikur më parë. Kjo është arsyeja pse Ongu vërejti se shoqëritë “orale” para-shkrim-lexim shpesh u duken vizitorëve nga vendet me kulturë shkrimi si jashtëzakonisht mistike, emocionale dhe antagoniste në diskursin dhe mënyrën e tyre të të menduarit.[4] Ndërsa librat po zhduken, duket se po kthehemi te këto zakone “orale” të të menduarit. Diskursi ynë po shembet në panik, urrejtje dhe luftëra tribale. Mendimi antishkencor lulëzon në nivelet më të larta të qeverisë amerikane. Promotorë të irracionales dhe teorive konspirative si Candace Owens dhe Russell Brand gjejnë



audienca të mëdha dhe të besueshme në internet. Të vëna në faqe, argumentet e tyre do të dukeshin absurde. Në ekran, ato janë bindëse për shumë njerëz. Rritja e këtyre stileve emocionale dhe irracionale të të menduarit paraqet një sfidë të thellë për kulturën dhe politikën tonë. Ne mund të jemi duke zbuluar se nuk është e mundur të drejtohet qytetërimi më i avancuar në historinë e planetit me aparatën intelektual të një shoqërie para-shkrim-lexim.

Fundi i krijimtarisë

Epoka e shtypit u karakterizua nga një dinamizëm dhe një pasuri të paprecedentë kulturore. Leximi është baza e krijimtarisë dhe inovacionit që janë thelbësorë për modernitetin. Nuk është e vërtetë se, që një shoqëri të përftojë nga kultura e shtypit, çdo qytetar duhet të jetë lexues i pasionuar i librave. Megjithatë, nëse ka një shprehje që bashkon udhëheqësit, shpikësit, shkencëtarët dhe artistët që kanë formuar qytetërimin tonë, ai është leximi. Lexuesit seriozë janë të përfaqësuar në mënyrë disproporcionale pothuajse në çdo fushë të arritjeve njerëzore. Merrni për shembull politikanët e mëdhenj: Teddy Roosevelt pretendonte se lexonte një libër në ditë, Winston Churchill i kishte vënë vetes një program ambicioz leximi në filozofi, ekonomi dhe histori kur ishte i ri dhe vazhdoi të lexonte me etje gjatë gjithë jetës së tij. Clement Attlee kujtonte se lexonte katër libra në javë kur ishte nxënës. Ose merrni parasysht kulturën popullore (e cila zakonisht nuk konsiderohet si fushë veçanërisht letrare e veprimtarisë njerëzore). David Bowie lexonte, sipas fjalëve të tij, “me pangopësi”. “Çdo libër që kam blerë, e kam ende. Nuk mund ta hedh tutje”, tha ai njëherë. “Është fizikisht e pamundur të largohet nga dora ime”! Një listë që Bowie shkroi me njëqind librat e tij të preferuar përfshin vepra të shkrimtarëve William Faulkner, Tom Stoppard, DH Lawrence dhe TS Eliot. Në një libër të fundit për karrierën e tij si autor këngësh, Paul McCartney përmendi emrat “Dylan Thomas, Oscar Wilde dhe Allen Ginsberg, si dhe shkrimtarin simbolist francez Alfred Jarry, pastaj Eugene O’Neill dhe Henrik Ibsen”, ndër autorët që atë e kishin frymëzuar.

Thomas Edisoni lexonte shumë gjatë gjithë jetës së tij. Po ashtu Charles Darwini. Po ashtu Albert Einstein. Për ironi, edhe Elon Musk pretendon se është “rritur nga librat”. Leximi e pasuron punën krijuese duke u dhënë burrave dhe grave gjenialë qasje në thesarin e gjerë dhe të paçmuar të dijes që ruhet në libra - “më të mirën që është menduar dhe thënë”. Disiplina e leximit i pajis ata me mjetet analitike për të shqyrtuar, përpunuar dhe revolucionarizuar atë traditë. Siç argumenton Elizabeth Eisenstein në librin Revolucioni i shtypit në Evropën e hershme moderne [The Printing Revolution in Early Modern Europe], shpikja e shtypshkronjës ndihmoi në katalizimin e një serie revolucionesh kulturore që skalitën botën moderne: Rilindjen, Reformacionin dhe revolucionin shkencor. Historianë të tjerë do të shtonin Iluminizmin, lindjen e të drejtave të njeriut dhe revolucionin industrial. Eisensteini shpjegon se si prirja e leximit për të nxitur inovacionin u shfaq në universitetet e Rilindjes. Me shpikjen e shtypit, studentët kishin qasje më të madhe në libra, duke lejuar që “studentët e zgjuar të kapërcenin kufijtë e njohurive të mësuesve të tyre. Studentët e talentuar nuk kishin më nevojë të uleshin në këmbët e një mjeshtri të caktuar për të mësuar një gjuhë ose një aftësi akademike”, Dhe, kështu studentët që përfitonin nga tekstet teknike që shërbenin si mësues të heshtur kishin më pak gjasa t’i nënshtrroheshin autoritetit tradicional dhe ishin më të hapur ndaj prirjeve inovative. Mendjet e reja të pajisura me botime të përditësuara, veçanërisht të teksteve matematikore, filluan të tejkalonin jo vetëm të pleqnarët e tyre, por edhe urtësinë e të lashtëve. Studentët modernë që nuk janë në gjendje të lexojnë janë sërish të varur nga autoriteti i mësuesve të tyre dhe janë më pak të aftë të ecin përpara, të zbulojnë dhe të vënë në pikëpyetje ortodoksitë. Këta studentë janë vetëm një simptomë e kulturës së stagnimit të epokës së ekranit, e cila karakterizohet nga thjeshtësia, përsëritja dhe e cekëta. Simptomat e saj mund të vërehen kudo rreth nesh. Këngët pop në çdo zhanër po bëhen më të shkurtra, më të thjeshta dhe më të përsëritshme, ndërsa filmat po reduktohen në

formula pafundësisht të përsëritura të franshizave. Studimet sugjerojnë se numri i shpikjeve “përçarëse” dhe “transformuese” është në rënie. Më shumë para shpenzohen për kërkime shkencore se kurrë më parë në histori, por ritmi i përparimit “mezi po arrin të mbajë hapin me të kaluarën”. Patjetër që shumë faktorë janë në veprim, por kjo është gjithashtu mu ajo që do të prisnit nga një brez studiuesish që kaluan fëmijërinë ngjitur për ekrane në vend që të lexonin ose të mendonin.

Edhe vetë librat po bëhen më pak kompleksë.

Nëse bota e shkrim-leximit karakterizohet nga kompleksiteti dhe inovacioni, bota post-shkrim-lexim karakterizohet nga thjeshtësia, padituria dhe stagnimi. Ndoshta nuk është rastësi që rënia e shkrim-leximit ka sjellë obsesion me “nostaljinë” kulturore; një dëshirë për të ricikluar pafundësisht format kulturore të së kaluarës: për shembull, serialet televizive dhe stilet e viteve ’90 të shekullit XX, ose modat e fillimit të viteve 2000.

Kultura jonë po shndërrohet në një shkretëtirë smartfonësh.

Të shpëputur nga pasuritë kulturore të së kaluarës, jemi të dënuar të jetojmë në një të tashme të përjetshme narciste. Të privuar nga mjetet kritike për të vënë në pikëpyetje dhe për të zhvilluar idetë e atyre që erdhën para nesh, jemi të dënuar të përsërisim pafundësisht veten tonë, një film superheroi pas një filmi superheroi, këngë e përsëritshme pop pas këngës së përsëritshme pop. Mbi të gjitha, kjo kulturë gjithnjë e më triviale dhe e pamend është fatkeqësi për politikën tonë.

Vdekja e demokracisë

Në mënyrë ironike nga perspektiva e së tashmes, revolucion i leximit i shekullit të tetëmbëdhjetë u shoqërua jo vetëm me entuziazëm, por edhe me një panik moral. “Asnjë dashamirës i duhanit apo i kafesë, asnjë pirës vere apo dashamirës i lojërave, nuk mund të jetë aq i varur nga llulla e tij, shishja, lojërat apo tryeza e kafesë sa janë ata shumë lexues të pangopur nga zakoni i tyre i leximit”, gjëmonte një klerik gjerman. Richard Steele kishte frikë se “romanet shtrajnë pritshmëri të cilat rrjedha e zakonshme e jetës nuk mund t’i realizojë kurrë”. Disa të tjerë shqetësoheshin se leximi “e nxit tepër imagjinatën dhe e lodh zemrën”. Është e lehtë të qeshësh me këto ankthe. E kemi kaluar gjithë jetën duke dëgjuar se sa e virtutshme dhe e arsyeshme është të lexosh libra. Si mund të jetë leximi i rrezikshëm? Por, në retrospektivë, këta moralistë konservatorë kishin të drejtë të shqetësoheshin. Zgjerimi i shpejtë i shkrim-leximit ndihmoi në shkatërrimin e botës së rregullt,

hierarkike dhe thellësisht të pabarabartë në aspektin shoqëror që ata çmonin. Revolucion i leximit ishte katastrofë për aristokratët jashtëzakonisht të privilegjuar dhe shfrytëzues të ancien régime-it aristokratik evropian - sistemi i vjetër autokratik i qeverisjes me mbretër të gjithëpushtetshëm në majë, me lordë dhe klerikë poshtë tyre dhe me fshatarë që përpëliteshin krejt në fund. Padituria ishte bazamenti i Evropës feudale. Pabarazitë e mëdha të rendit aristokratik mund të ruheshin pjesërisht sepse popullsia nuk kishte asnjë mënyrë për të zbuluar përmasat e korrupsionit, abuzimeve dhe paaftësive të qeverive të tyre. Dhe, hierarkia e vjetër feudale justifikohet jo aq shumë me argumente logjike sa me atë që Walter Ongu mund ta kishte njohur si thirrje shumë para-shkrim-leximit ndaj mendimit mistik dhe emocional. Kjo ishte ajo që historianët e shekullit të shtatëmbëdhjetë e quajnë kultura “përfaqësuese” e pushtetit, sistemi shumë vizual i propagandës monarkike që impononte mbi nënshtetasit imazhin e frikshëm dhe madhështor të mbretit. Regjimi e shfaqte fuqinë e tij në parada, piktura, shfaqje fishekzjarrësh, statuja dhe ndërtesa madhështore. Sistemi funksiononte në një epokë para shkrim-leximit masiv. Por, ndërsa dija u përhap nëpër shoqëri dhe mënyrat analitike e kritike të të menduarit të nxitura nga shtypi filluan të zinin vend, e gjithë atmosfera mendore dhe kulturore që mbështeste rendin e vjetër u dogj. Njerëzit filluan të dinin shumë. Dhe, të mendonin shumë. Rendi feudal duket se është në thelb i papajtueshëm me shkrim-leximin. Historiani Orlando Figes ka vënë në dukje se revolucionet angleze, franceze dhe ruse ndodhën që të gjitha në shoqëri ku niveli i shkrim-leximit po i afrohej pesëdhjetë përqindëshit. Libri i Robert Darntonit, Temperamenti revolucionar [The Revolutionary Temper], përshkruan kaosin që epoka e shtypit lëshoi mbi regjimin e vjetër në Francë. Dija u përhap në shoqërinë franceze me pasoja katastrofike: të burgosurit politikë shkruanin kujtime bestseller që njoftonin burgosjen e tyre të padrejtë nga shteti; njerëzit e zakonshëm lexonin pamflete për pasurinë e tepruar dhe të padrejtë që gëzonin aristokratët; financat katastrofike të qeverisë papritur filluan të debatoheshin nga një publik i habitur dhe i zemëruar, në vend që të diskutoheshin prapa dyerve të mbyllura në dhomat e pasme të Versajës. Ndërkohë, mënyrat analitike dhe kritike të të menduarit filluan të gërryenin themelet mistike dhe emocionale të rendit të vjetër. Filozofët dhe mendimtarët radikalë të Iluminizmit, të mbështetur nga një publik gjithnjë në rritje i klasës së mesme lexuese, filluan të bënin pyetje kritike të atij lloji që në thelb janë të lidhura me kulturën e shtypit. Nga vjen pushteti? Pse disa njerëz duhet të kenë shumë më tepër se të tjerët? Pse nuk janë të gjithë njerëzit të barabartë? *** Vlen të theksohet se ky



përshkrim shumë i thjeshtuar përjashton qartë shumë nga faktorët që modelojnë rrjedhën e historisë: ekonominë, klimën, burrat dhe gratë individuale, rastësinë. Vetëm shtypi nuk mund të sjellë paqe dhe demokraci (mjafton të shohim pasojat e revolucionit rus). Dhe, shtypi nuk mund të zhdukë tendencat e lindura njerëzore ndaj partive dhe dhunës (mjafton të shohim pasojat e revolucionit francez). Shtypi sigurisht nuk është imun ndaj lajmeve të rreme dhe teorive konspirative (mjafton të shohim periudhën para revolucionit francez) *** Por, nuk është e nevojshme të besosh se shtypi është sistem i përsosur dhe i pakorruptueshëm komunikimi për të pranuar se ai është gjithashtu pothuajse me siguri një kusht i domosdoshëm paraprak për demokracinë. Në Duke zbavitur veten deri në vdekje, Neil Postmani argumenton se demokracia dhe shtypi janë pothuajse të pandashëm. Një demokraci efektive presupozon një qytetari relativisht të informuar dhe disi kritike, të aftë për të kuptuar dhe debatuar çështjet e ditës gjerë e gjatë. Demokracia merr forcë të pamatshme nga shtypi - nga bota e vjetër që po vdes e librave, gazetave dhe revistave - me prirjen e saj për të nxitur njohuri të thella, argument logjik, mendim kritik, objektivitet dhe angazhim të paanshëm. Në këtë mjedis, njerëzit e zakonshëm kanë mjetet për të kuptuar sundimtarët e tyre, për t’i kritikuar dhe, ndoshta, për t’i ndryshuar. Postmani përmend debatet Lincoln-Douglas të vitit 1858, në të cilat të dy kandidatët presidencialë folën për një kohë jashtëzakonisht të gjatë dhe me një nivel të jashtëzakonshëm detajesh, si një nga kulmet e kulturës së shtypit: Rregullat e debatit parashikonin që Douglasi të fliste i pari për një orë; Lincoln do të përgjigjej për një orë e gjysmë; Douglasi pastaj kishte gjysmë ore për t’iu kundërpërgjigjur përgjigjes së Lincolnit. Ky debat ishte dukshëm më i shkurtër se ato me të cilat të dy burrat ishin mësuar ... më 16 tetor 1854, në Poria të Illinoisit, Douglasi mbajti një fjalim prej tre orësh, të cilit Lincoln, sipas marrëveshjes, do t’i përgjigjej. Kur Postmani shkruante në fund të viteve 1980, debatet e tilla tashmë ishin të


paimagjinueshme. Për ironi, debatet televizive që ai i kritikonte si të degraduara, të painformuara dhe tepër emocionale, sot u duken shikuesve të shekullit njëzet e një pothuajse të qytetëruara dhe në nivel të lartë intelektual. Politika në epokën e videove të shkurtra favorizon emocionin e shtuar, paditurinë dhe pohimet pa prova. Në rrethana të tilla, mashtruesit karizmatikë kanë kushte shumë të favorshme. Në mënyrë të pashmangshme, partitë dhe politikanët armiqësorë ndaj demokracisë lulëzojnë në botën post-shkrim-lexim. Përdorimi i TikTok-ut lidhet me rritjen e përqindjes së votave për partitë populiste dhe të djathtë ekstreme. TikTok-u, siç thotë shkrimtari Ian Leslie, është “karburant rakotor për populistët”. Pse i sjell përfitim [TikTok-u] populistëve në mënyrë disproporcionale? Sepse, pothuajse sipas përkufizimit, populizmi lulëzon mbi emocionet, jo mbi mendimet; mbi ndjenjat, jo mbi fjalitë. Populistët specializohen në dhënie të atij shpërthimi sigurie që ndien kur e di se ke të drejtë. Ata nuk duan që ju të mendoni. Mendimi është vendi ku siguria shkon për të vdekur. Rendi liberal demokratik racional dhe i paanshëm i bazuar në shtyp mund të mos mbijetojë këtë revolucion.

Në ferrin e budallallëkut

Kompanitë e mëdha të teknologjisë pëlqejnë ta shohin veten si të përkushtuara ndaj përhapjes së dijes dhe kureshtjes. Në fakt, për të mbijetuar, ato duhet të promovojnë budallallëkun. Oligarkët e teknologjisë kanë po aq interes në paditurinë e popullsisë sa edhe autokratët më reaksionarë feudalë. Zemërimi i verbër dhe mendimi partiak na mbajnë të ngjitur për telefonat tanë. Dhe, ndërsa monarkitë e vjetra evropiane duhej (shpesh në mënyrë të pasuksesshme) të përpiqeshin të censuronin materialin e rrezikshëm kritik, kompanitë e mëdha të teknologjisë e sigurojnë paditurinë tonë shumë më me efikasitet duke e përmbytur kulturën tonë me zemërim, shpërqendrim dhe kotësi. Këto kompani po punojnë në mënyrë aktive për të shkatërruar iluminizmin njerëzor dhe për të

sjellë një epokë të re të errët. Revolucion i ekranit do ta skalisë politikën tonë po aq thellë sa revolucion i leximit i shekullit të tetëmbëdhjetë. Pa dijen dhe pa aftësitë e mendimit kritik që ushqehen nga shtypi, shumë qytetarë të demokracive moderne janë po aq të pafuqishëm dhe po aq të besueshëm sa fshatarët mesjetarë - që preken prej thirrjeve irracionale dhe që janë të prirë ndaj mendimit të turmës. Bota pas shtypit i ngjan gjithnjë e më shumë botës para shtypit. Besëtytnitë dhe mendimi antidemokratik lulëzojnë. Kërkimi studimor në universitetet tona formësohet nga përkatësia e ngurtë partiake, jo nga toleranca dhe kureshtja. Arti dhe letërsia jonë janë më të ashpra dhe më të thjeshta. Shumë njerëz sot janë po aq dyshues ndaj vaksinave sa fshatarët e paarsimuar të shekullit të tetëmbëdhjetë të satirizuar nga karikaturisti James Gillray më shumë se dyqind vjet më parë. Ndërsa pushteti, pasuria dhe dija përqendrohen në majë të shoqërisë, një publik i zemëruar, i përçarë dhe i painformuar nuk ka një mënyrë për të kuptuar, analizuar, kritikuar apo ndryshuar atë që po ndodh. Në vend të kësaj, gjithnjë e më shumë njerëz impresionohen nga ato lloje thirrjesh shumë emocionale, karizmatike dhe mistike që ishin themeli i pushtetit në epokën para përhapjes së shkrim-leximit. Ashtu siç ardhja e shtypit i dha goditjen përfundimtare botës së kalbur të feudalizmit, kështu edhe ekрани po shkatërron botën e demokracisë liberale. Ndërsa kompanitë e teknologjisë zhdukin shkrim-leximin dhe vendet e punës të klasës së mesme, ne mund të përfundojmë në një epokë të dytë feudale. Ose mbase po hymjë në një epokë politike përtej imagjinatës sonë. Çfarëdo që të ndodhë, ne tashmë po shohim botën që dikur njihnim teksa po shkrihet. Asgjë nuk do të jetë kurrë më njësor. Mirë se vini në shoqërinë post-shkrim-lexim. /Telegrafi/

[1] Kur George Orwell raportoi në vitin 1940 mbi një studim të ri të botuar për zakonet e leximit të fëmijëve, ai zbuloi se fëmijët lexonin “vullnetarisht” veprat e shkruara nga Charles Dickens, Daniel Defoe, Robert Louis Stevenson, GK Chesterton dhe Shakespeare. Këta fëmijë, vuri ai në dukje, “ishin të moshës midis 12 dhe 15 vjeç dhe i përkisnin shtresës më të varfër të komunitetit”. [2] Protestoj duke thënë se kam lexuar Peter Brownin dhe e pranoj se ky është një karakterizim i thjeshtuar (edhe pse shpresoj i fuqishëm në aspektin retorik) i antikitetit të vonë. Por, mendoj gjithashtu se përpjekjet e fundit në modë për ta riemërtuar “Mesjetën e errët” si “Epokën e dritës” mund të jenë paksa të tepruara. Normat e shkrim-leximit në antikitetin e vonë vërtet kanë rënë. [3] Njerëzit ndonjëherë kundërshtojnë duke thënë Sokrati vajtonte vdekjen [e shkaktuar!] nga shkrimi. Argumenti i hollësishtëm i Havelockut, siç paraqitet në librin e tij Parathënie për Platonin [Preface to Plato], ia vlen të lexohet i plotë. Një pikë që ai thekson është se vetë Sokrati ishte produkt i një klime intelektuale që tashmë po ndikohej thellësisht nga shkrimi. Platoni, sipas Havelockut, ishte militant aktiv kundër mënyrave të të menduarit para-shkrim-lexim. [4] Kjo nuk do të thotë se shoqëritë që dinë shkrim-lexim janë “më të mira” ose më inteligjente se shoqëritë orale. Siç shkruan Ongu, shoqëritë orale janë të afta për bëma të kujtesës që janë mahnitëse për të huajt. Por, është e vërtetë se zakonet e të menduarit të lidhura me shkrim-leximin duket se janë thelbësore për llojin e qytetërimit të përparuar dhe kompleks në të cilin jetojmë.



Ballkani ruan lidershipin në Superligë

SUHAREKË, 18 MARS - Ballkani dhe Drita janë shkëputur edhe më shumë në krye të tabelës pasi kanë shënuar fitore edhe në ndeshjet e xhiros së 25-të të Superligës së Kosovës në

futboll. Ballkani ka mposhtur 1:0 Prishtinën e Re, ekip që mbetet në fund të tabelës me 23 pikë. Golin e vetëm në këtë përballje e ka realizuar Bleart Tolaj, ndërsa Drita ka triumfuar

2:1 ndaj Dukagjinit, që nuk di për fitore në 10 ndeshjet e fundit dhe mbetet në pozitën e gjashtë me 33 pikë të mbledhura. Me këto fitore Ballkani dhe Drita gjenden në

vendin e parë dhe të dytë me nga 45 pikë, por klubi nga Suhareka ka golaverazh më të mirë. Xhiroja e 25-të e Superligës është mbyllur me fitoren e Gjilanit kundër Llavit.



NIS ZGJERIMI I QENDRËS NACIONALE TË XHUDOS NË PEJË, PROJEKT NË VLERË MBI 5.7 MILIONË EURO

PEJË, 18 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Sportit, Blerim Gashani, anëtarë të tjerë të kabinetit qeveritar, kryetarin e Federatës së Xhudos, Agron Kuka dhe kryemjeshtrin e xhudos, Driton Kuka, kanë vënë gurthemelin e projektit në vlerë më shumë se 5.7 milionë euro për zgjerimin e Qendrës Nationale të Xhudos në Pejë. “Këtu në Pejë, në lagjen e kampionëve të botës, nuk po vendosim vetëm gurthemel, por po vazhdojmë suksesin e xhudos së Kosovës”, ka thënë kryeministri Kurti, duke shtuar

se xhudoja është suksesi më i madh që Kosova ka ndërtuar si shtet në sport. Kurti ka thënë se një pjesë e rrugës drejt medaljeve olimpike në Paris 2024 është ndërtuar në këtë qendër, që ishte përruruar në shtator të vitit 2021. “Me angazhimin e pandalshëm të Federatës së Xhudos për ta ngritur Kosovën edhe më lart, në kuadër të programit ‘Kosova, Shtet i Xhudos’, sot po nisim këtë investim të ri. Ky projekt përfshin: palestër të re të xhudos me standarde ndërkombëtare dhe objekt multifunksional që përfshin akomodim, pishinë,



sallë fitnesi dhe restaurant”, ka thënë kryeministri Kurti. Kryeministri Kurti ka thënë se investimet në kuadër të programit “Kosova, Shtet i Xhudos”, përfshirë këtë projekt në vlerë më shumë se 5.7 milionë euro, janë përgjigje ndaj sukseseve dhe rezultateve që

xhudoja i ka sjellë Kosovës. Në palestrën e re, në kuadër të Qendrës Nationale të Xhudos, do të zhvillohen edhe garat e sporteve luftarake në kuadër të Lojërave Mesdhetare 2030. Kryetari i Federatës së Xhudos, Agron Kuka, ka falënderuar kryeministrin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës për këtë investim që u jep të rinjve mundësi për zhvillimin e tyre dhe promovimin e vendit. Ndërsa ka evokuar kujtime nga koha e okupimit kur në një palestër të vogël private nisi rrugëtimi i vështirë drejt lavdisë dhe medaljeve olimpike.

Krahas falënderimeve e mirënjohjes, kryemjeshtri i xhudos, trajneri Driton Kuka, ka thënë se “shteti tash po investon shumë seriozisht në ju, e ju duhet t’ia ktheni me punë, përkushtim e rezultate”, u ka thënë xhudistëve. Me këtë rast, kryeministri Kurti ka përshëndetur sportistët nga Ukraina, të cilët janë duke u stërvitur në Qendrën Nationale të Xhudos në Pejë, ndërsa ata i kanë falënderuar kryeministrin Kurti dhe Kosovën për mbështetjen dhe mikpritjen, duke thënë se po ndihen të sigurt dhe si në shtëpi.

SHKON AFRIM TOVËRLANI, VJEN ALBAN DRAGUSHA NË KRYE TË PRISHTINËS

PRISHTINË, 18 MARS - Alban Dragusha edhe zyrtarisht është trajner i skuadrës së Prishtinës pasi të mërkurën është paraqitur në krye të klubit nga kryeqyteti. Dragusha ka marrë drejtimin e Prishtinës një ditë pas largimit të Afrim Tovërlanit dhe shkëputjes së kontratës që e kishte me Ramiz Sadikut, ekip që bën gara në Ligën e Parë. “Trajneri 44-vjeçar vjen pas një periudhe të suksesshme te



skuadra e Ramiz Sadikut, të cilën e ka drejtuar që nga korriku i vitit 2023. Nën udhëheqjen e tij kjo skuadër u shndërrua në një nga befasitë më të këndshme të ligës së parë në këtë sezon”, ka njoftuar FC Prishtina. Hollësitë e marrëveshjes me Dragushën nuk janë bërë me dije, por është raportuar në medie se trajneri i ri ka firmosur kontratë deri në fund të këtij

seazoni me opsionin e vazhimit edhe për sezonin e ardhshëm. Dragusha në krye të Prishtinës do të debutojë në ndeshjen kundër Ballkanit, e cila luhet të shtunën mbrëma në stadiumin “Fadil Vokrri” në kryeqytet dhe takon xhiros së 26. Përveç Ramiz Sadikut, Dragusha ka qenë edhe trajner te Vushtrria, si dhe ndihmëstrajner i Dritës, përpara se ta marrë drejtimin e Prishtinës. Si futbollist,

Dragusha ka një karrierë të pasur pasi, krahas Kosovës, ka luajtur edhe në Ukrainë, Azerbajxhan, Suedi dhe Shqipëri. Ai është trajneri i tretë te Prishtina këtë sezon, pasi para Tovërlanit ekipin e ka udhëhequr Arsim Thaqi. Aktualisht Prishtina zë vendin e tretë në tabelë me 38 pikë dhe është në seri prej pesë ndeshjeve rresht pa fitore, duke regjistruar tri humbje dhe dy barazime.

SENEGALIT I HIQET TITULLI, MAROKU SHPALLET KAMPION I AFRIKËS

KAJRO, 18 MARS - Një vendim i bujshëm ka ardhur nga Konfederata Afrikane e Futbollit (CAF), pasi Komiteti i Apelit ka vendosur t’ia heqë titullin Senegalit nga Kupa e Kombeve të Afrikës 2026 dhe të shpallë kampion Marokun. Sipas vendimit zyrtar, finalja e këtij edicioni ndaj Marokut është regjistruar me rezultat 3-0 në favor të marokenëve, pasi është konstatuar se Senegali ka bërë shkelje të rregullores duke u tërhequr nga loja. Ky vendim ka ardhur pas apelit të paraqitur nga Federata Marokene, duke u bazuar në nenet 82 dhe 84 të

rregullores së garës. Komiteti i Apelit i CAF-it e ka pranuar ankesën dhe ka rrëzuar vendimin e mëparshëm të Komitetit Disiplinor, duke e konsideruar sjelljen e Senegalit si dorëzim të ndeshjes. Si pasojë, sipas Nenit 84, ndeshja është regjistruar zyrtarisht 3-0 për Marokun, që automatikisht shpallet kampion.

Çfarë kishte ndodhur në finale?

Finalja e zhvilluar më 18 janar 2026 ishte shoqëruar me tensione të mëdha dhe vendime

shumë të diskutueshme të gjyqtarit Jean-Jacques Ndala. Në minutat shtesë të kohës së rregullt, Senegali kishte arritur të shënojë për 1-0, por goli ishte anuluar për një faull të diskutueshëm në sulm. Vetëm pak minuta më vonë gjyqtari kishte akorduar penallti për Marokun pas një ndërhyrjeje në zonë, vendim që ishte konfirmuar edhe nga VAR-i, duke shkaktuar reagime të ashpra nga lojtarët dhe stafi senegalez. Në kulmin e tensionit, trajneri Pape Thiaw kishte urdhëruar lojtarët të largoheshin nga fusha në shenjë



proteste. Pas rreth 20 minutash ndërprerje, skuadra senegaleze ishte rikthyer në fushë për ta vazhduar lojën. Penalltinë vendimtare e kishte marrë

përsipër Brahim Diaz, i cili pati tentuar një goditje në stilin “Panenka”, por portieri Edouard Mendy ishte në nivel të detyrës. Ndeshja kishte shkuar në vazhdimë, ku Pape Gueye pati shënuar golin e fitores për 1-0, duke i dhënë Senegalit titullin në fushë. Megjithatë, vendimi i fundit i CAF-it e përmbys plotësisht epilogun e finales, duke ia hequr trofeun Senegalit dhe duke e kaluar atë në duart e Marokut, në një nga rastet më të rralla dhe më kontroverse në historinë e futbollit afrikan.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja
Ministry of Environment Spatial and Planning

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Plotësim Ndryshimin e Kushteve Ndërtimore nga EV WIND PARK SH.P.K. me nr. të protokolit 9090/25 të datës 22.12.2025 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet projekti " NËNSTACIONI EV WIND PARK ZATRIQ 1-35MW " me infrastrukturën përcjellëse që ndodhen në Zonën Kadastrale Zatriq me numër të parcelave: 01119-1, 01112-0 dhe 00530-1, 00544-0 në Komunën e Rahovecit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Plotësim Ndryshimin e Kushteve Ndërtimore për projektin " NËNSTACIONI EV WIND PARK ZATRIQ 1-35MW " për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji me erë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.01.04.2026 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:
Plotësim Ndryshimi I Kushteve Ndërtimore të propozuara: EV WIND PARK SH.P.K. projekti-" NËNSTACIONI EV WIND PARK ZATRIQ 1-35MW " Z.K. Zatriq - Komuna e Rahovecit"

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Arë e klasës 7, 8 dhe Kullosë e klasës 5 dhe 6, Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli	
b. Vija rregulluese.	7.5 m' 27.5 m'
c. Vija e ndërtimit.	2.45 m' 10.11 m'
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	4.5 m' 9.72-18.69 m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	4.5 m' 67.01-90.82 m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	8.13 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	76.91 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	30
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Struktura mbajtëse beton-arme, konstruksioni i turbinave çelik. Mbulesa e nenstacionit me kulm te rrafshet te pashfrytezueshem me shtresa izoluese

I. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐
Nuk aplikohet ☐

m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth?
Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:

n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NJOFTIM MBI ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Në përputhje me nenin 17 të “Rregulloren për Procedurat e Prokurimit të OMK-së”

Data: 17.03.2026

- I. “Oda e Mjekëve të Kosovës”
Adresa: Instituti A, QKUK, Kati 3, 10 000 Prishtinë
- II. Lënda e procedurës së prokurimit:
II.1 Titulli i kontratës: “Kontratë për Shërbime të Transportit Ajror”
II.2 Numërtimi i prokurimit: “OMK 02 26”
II.3 Lloji i procedurës: Procedurë e hapur e prokurimit
II.4 Lloji i prokurimit: Shërbim
II.5 Numri i tenderëve të pranuar: 1 (një)
- III. Anulimi i procedurës së prokurimit:
III.1 Data e anulimit të procedurës: 17.03.2026
III.2 Arsyeja e anulimit: Pas hapjes së tenderëve, një dispozitë në Rregulloren për Procedurat e Prokurimit të OMK-së kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit; Anulimi i kësaj procedure të prokurimit është bërë në përputhje me “Rregulloren për Procedurat e Prokurimit të OMK-së”

IV. Ankesat
Në përputhje me “Rregulloren për Procedurat e Prokurimit të OMK-së”, respektivisht sipas Neni 20 “Ankesat në procedurë të prokurimit”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Odës së Mjekëve: Instituti A, QKUK, Kati 3, 10 000 Prishtinë, www.omk-rks.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në zyrën e OMK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme.

NJOFTIM MBI ZVOGËLIMIN E KAPITALIT AKSIONAR

Përmes këtij publikimi, njoftojmë palët e interesuara dhe publikun e gjërë se në mbledhjen e mbajtur më datë 18.03.2026 aksionarët e shoqërisë tregtare Apetit sh.p.k. me adresë në Babimofc, komuna e Obiliqit, Magj. Prishtinë - Mitrovicë, Km.11, me numër unik identifikues 811106823, numër fiskal 600911417 dhe numër të TVSH-së 330186248, kanë marrë vendim mbi zvogëlimin e kapitalit aksionar nga 9,645,355.00 euro në 9,084,093.60 euro. Arsyeja për këtë zvogëlim të kapitalit është transferimi i pjesshëm i biznesit me vlerë të transferit prej 561,261.40 euro prej Apetit sh.p.k. te biznesi Amazona Hotel sh.p.k. me numër unik identifikues 810129157, dhe numër të TVSH-së 330391756, me adresë kryesore të biznesit në adresë në Babimofc, komuna e Obiliqit.
Zvogëlimi i kapitalit aksionar të shoqërisë tregtare Apetit sh.p.k. është bërë konform nenit 165 të Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe dispozitave të Statutit të shoqërisë tregtare Apetit sh.p.k.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita: Mbikëqyrës i Sistemeve të TI-së dhe Rrezikut Kibernetik (2 pozita)
Niveli i gradës: P06
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti/ Divizioni: Divizioni i Mbikëqyrjes së Sistemeve të TI-së
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit

Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësiave:

Përmbledhje e Pozitës

